

RAPORT MBI KAPITULLIN 2 TË LIGJIT TË BE-SË “LIRIA E LËVIZJES SË PUNËTORËVE¹”

Experte: PhD. Evis Garunja

Autor: © Qendra për të Drejtat në Punë, CLR

¹ Regulation (EU) No 492/2011 on the right of EU workers to move within the EU

Hyrje

Lëvizja e lirë e punëtorëve së bashku me lëvizjen e lirë të mallrave, shërbimeve dhe kapitalit garantohet nga e drejta e Bashkimit Europian si një shtyllat e tregut të përbashkët dhe lirive themelore. Neni 45 TFBE (neni 39 TKE), garanton se *“çdo qytetar i BE-së ka të drejtë të lëvizë lirshëm, të qëndrojë dhe të punojë, me disa përjashtime në sektorit publik, në një shtet tjetër anëtar pa u diskriminuar në bazë të kombësisë, sa i takon kushteve të punës, ndihmës sociale dhe taksimin”*. Rregullat e BE-së për lëvizjen e lirë të punëtorëve vlejnë edhe për Zonën Ekonomike Evropiane (ku bëjnë pjesë Islanda, Lihtenshtajni dhe Norvegjia).

Garantohet në këtë kapitull trajtim i barabartë për sa i përket kushteve të marrjes në punë, shpërblimit dhe largimi nga puna por edhe përfitimi i avantazheve sociale rrjedhojë e një kontrate pune, ose pagesa e papunësisë, që përgjithësisht u jepen punëtorëve vendas në kuadër të statusit të tyre si punëtorë ose për shkak të residencës së tyre në territor kombëtar.

Garancitë e ligjit europian nuk kufizohen vetëm tek punëtorët, por efektet shtrihen edhe tek anëtarët e familjeve të tyre që lëvizin në një Shtet tjetër Anëtar. Për të bërë të mundur këtë krijohen mekanizmat e posaçme në koordinimin e dispozitave mbi sigurimet shoqërore kombëtare për personat e siguruar, të vetëpunësuar, apo përfituesve të pensionit suplementar.

Një impakt të rëndësishëm në përcaktimin e nocionit *“punëtor”* ka ofruar jurisprudenca e GJED-së e cila me interpretimin e saj ka vendosur standarte mbi vetë konceptet e lirisë së lëvizjes dhe pasojat e kësaj lirie.

Promovimi i lirisë së lëvizjes për punëtorët brenda BE-së realizohet nëpërmjet sistemit EURES (Shërbimi Evropian i Punësimit) i cili mbështetet bashkëpunimin e shërbimeve kombëtare të punësimit në shkëmbimin e informacionit mbi mundësitë e punësimit. Kjo përbën një sfidë për vendet candidate të cilat duhet të integrojnë të dhënat mbi vendet e lira të punës me kërkësat e EURES, ofrimin i një informacioni të përgjithshëm mbi tregun e punës, mbi jetesën dhe kushtet e punës që kërkohet të arrihet.

Mundësimi i të drejtës për lëvizjen e lirë të punëtorëve plotësohet nga një koordinim i sistemeve të sigurimeve shoqërore, d.m.th. e drejta për punëtorët migrantë dhe e të afërmeve / apo personat në ngarkim të tyre për të fituar, grumbulluar ose transferuar përfitime të sigurimeve shoqërore, si dhe për të marrë pagesën e këtyre përfitimeve. Kjo bazohet në Rregullore të cilat bashkërendojnë sistemet e sigurimeve shoqërore të Shteteve Anëtare, dhe që kërkojnë një bashkëpunim administrativ midis këtyre shteteve.

Në fushën e kujdesit shëndetësor, shpenzimet mjekësore duhet të rimbursohen për të gjithë trajtimin e nevojshëm të shtetasve që sëmuren ose që mund të kenë patur një aksident gjatë një qëndrimi të përkohshëm në një shtet tjetër anëtar, p.sh. si turistë. Për këtë arsye, në ndihmë të të gjithë qytetarëve të vendeve anëtare vjen në ndihmë Karta Evropiane e Sigurimit Shëndetësor.

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit e ratifikuar me Ligjin Nr. 9590, datë 27.07.2006 “Për ratifikimin e ‘Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane e shteteve të tyre anëtare”, përcakton në nenin 70 të saj detyrimin e Republikës së Shqipërisë për përafrimin e legjislacionit kombëtar me legjislacionin e Bashkimit Evropian në përputhje me afatet e përcaktuara nga kjo Marrëveshje.

Procesi i anëtarësimit në Bashkimin Europian është përcaktuar nga qeveria Shqiptare si një objektiv kombëtar, në funksion të demokratizimit dhe transformimit të shoqërisë shqiptare, në përputhje me vlerat dhe parimet e Europës së Bashkuar. Për t’i dhënë fund, kësisoj, një tranzicioni të pafund që nuk krijon institucione demokratike, modele zhvillimi të qëndrueshme dhe cilësi jete.

Qëllimi i Kapitullit 2

Kapitulli 2 do të fokusohet në çështje të rëndësishme si:

- Lëvizja e lirë e punëtorëve në BE ose jashtë saj. Kjo synon ofrimin e garancive ligjore për të parët dhe për të dytët të fitojnë eksperiencë dhe plotësojnë nevojat për punësim.
- Kjo lëvizje ndihmon në një kërkesë dhe ofertë të balancuar për vendet e punës si brenda EU-së ashtu dhe në tërheqjen e krahut të lirë të punës jashtë saj.
- Evidentimi i legjislacionit Europian në fuqi i cili mundëson dhe garanton këtë të drejtë. Çfarë garanton ai (eliminimin e çdo forme diskriminimi kombëtar midis punëtorëve në Europë, procedura të ndryshme e të mirëpërcaktuara në rekrutimin e punonjësve nga shtetet anëtare, kushte të ndryshme për punonjës jashtë BE-së, aksesin në punësim, kushte në punë apo aksesin në trajnim.
- Këto standarde do të shoqërojnë jo vetëm punonjësit por dhe familjarët e tyre (bashkëjetuesi, fëmija etj.)
- Anëtarësimi në sindikata dhe garancitë që ofron ligji në pjesëmarrjen në to dhe roli që kanë në promovimin e të drejtave të punonjësve.
- Garantimi i mbrojtjes së të drejtave sociale / banesës të punonjësve duke njohur dhe garantuar ato, pavarësisht nga vendi i prejardhjes së punëtorit (BE).

1. Situata e të huajve në Shqipëri

Gjithmonë e më shumë Shqipëria po njih rritje të numrit të qytetarëve të huaj, punëkërkuar, studentë, azilkërkuar dhe refugjatë, situatë e cila ka kërkuar marrjen e masave ligjore për të sistemuar statusin e tyre, kërkesë kjo për përafrimin e kuadrit ligjor me atë të BE. Nga 13.609 banorë të huaj me leje qëndrimi, në 2020² janë në Shqipëri, 64,0 % janë meshkuj dhe 36,0 % femra. Krahasuar me 2019 kemi një rritje me 0,8 %.

² Instat 2021, <http://www.instat.gov.al/>

Gjatë 2020 janë rregjistruar 7.661 aplikime për leje qëndrimi në Shqipëri, me një rënie me 7%, krahasuar me vitin 2019 nga të cilat 47,5 % për arsye pune, 24,5 % bashkim familjar, 19,7 % qëllime humanitare, 2% për studim dhe 6,3 % arsye të tjera. Në vitin 2020 janë evidentuar 18.835 të huaj të parregullt në territorin e vendit ku pjesën më të madhe të tyre prej 55,9 % e zënë të huajt me origjinë nga Iraku dhe Siria.

Në kategorinë e të huajve me leje qëndrimi në Shqipëri, sipas vendit të origjinës, të huajt nga vendet e Evropës përbëjnë 56,8 % të të huajve rezident gjithsej (7.724 banorë), nga Azia janë 4.048, nga Amerika, Afrika dhe Oqeania janë 1.837.

Përafrimi i legjislacionit të emigracionit me *Acquis* të BE-së dhe konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Shqipëria është një proces në vijim. Si kërkesë e Marrëveshjes së Stabilizimit Asocimit, standartizimi i ligjeve me fokus lirinë e lëvizjes për punëtorët synon jo vetëm garantimin e të drejtave të tyre por edhe lëvizjen e lirë të anëtarëve të familjes së qytetarëve të BE-së. Raporti i KE (2020) vlerëson progresin e Shqipërisë në këtë fushë³, por zbatimi dhe garantimi i të drejtave të tyre në praktikë kërkon ende një vëmendje e monitorim të veçantë.

Ligji nr.9861/2008 “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror” dhe ligji nr.108/2013 “Për të huajt”⁴ janë dy ligjet kryesore që rregullojnë migracionin e qytetarëve të huaj në Shqipëri.

A. Aksesi në tregun e punës A.1 Kuadri ligjor në fuqi

1. *Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë* në Kreun I të saj, Neni 15 sanksionon të drejtat dhe liritë themelore të njeriut si të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe që qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. Në vijim, ajo përcakton detyrimin e organeve të pushtetit publik, në respektimin dhe realizimin e tyre⁵. Në nenin 16, Kushtetuta deklaron mbrojtje dhe garanci të barabarta për të drejtat dhe liritë themelore si për shtetasit shqiptarë ashtu dhe ata të huaj e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë. Përfundimisht bëhet vetëm në rastin kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme shtetësinë shqiptare me ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara⁶. Në këtë frymë është edhe përcaktimi që bëhet në nenin 17/1 të saj mbi kufizimin e të drejtave dhe lirive të parashikuara në Kushtetutë vetëm me ligj për një

³ Ndryshimet kryesore legislative paraqesin disa nga momentet kryesore në këtë drejtim, ku ia vlen të përmenden: miratimi i Ligjit nr. 108/2013 për të huajt (i ndryshuar), Ligji nr. 121/2014 për Azilin në Republikën e Shqipërisë; Udhëzimi nr. 293/2015 i Ministrisë të Brendshme për procedurat e trajtimit të të huajve me qëndrim të parregullt në Shqipëri; Urdhri nr.1146/2014 i Ministrisë të Brendshme për disa shtesa dhe ndryshime në Urdhrin nr.851/2009 për miratimin e Procedurave Standarde të Punës për Kufirin dhe Migracionin; miratimi i Ligjit nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, fusha e zbatimit të të cilit përfshin fëmijët me shtetësi shqiptare, por edhe ata pa shtetësi ose me shtetësi të huaj, të cilët ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

⁴ I shfuqizuar me ligjin nr.79/2021 “Për të huajt”

⁵ Kreu I. Parime të Përgjithshme. Neni 15 1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik. 2. Organet e pushtetit publik, në përbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

⁶ Neni 16/1 Kushtetutës “1. Të drejtat e liritë themelore, si dhe detyrimet e parashikuara në Kushtetutë për shtetasit shqiptarë vlejnë njëjloj edhe për të huajt e për personat pa shtetësi në territorin e Republikës së Shqipërisë, me përjashtim të rasteve kur Kushtetuta e lidh në mënyrë të posaçme me shtetësinë shqiptare ushtrimin e të drejtave e të lirive të caktuara”

interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve dhe në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë. Vetëm në këtë rast qytetari shqiptar dhe i huaj do të jetë subjekt i kufizimit ligjor apo “kushtëzimit/cënimit” të të drejtës së tij⁷. Liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore sanksionohen nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, duke filluar nga e drejta për punë. Në nenin 49 të saj përcaktohet se: “ 1. Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur pse pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës, si dhe sistemin e kualifikimit të vet profesional. 3. Të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës”.

2. Ligji nr. 79/2021 “Për të Huajt⁸” synon përafrimin e rendit juridik shqiptar me *acquis* të BE-së. Subjekt të ligjit janë të gjithë shtetasit e huaj të cilët hyjnë ose synojnë të hyjnë në Republikën e Shqipërisë, me qëllim qëndrimin, kalimin transit, punësimin, studimin, si dhe në rastet kur dalin nga Republika e Shqipërisë (neni 1). Neni 5⁹ i këtij ligji sanksionon të drejtat dhe detyrimet e të huajve duke renditur që të drejtat e tyre rrjedhin nga Kushtetuta e RSH dhe Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara.

Sipas tij, një kategori e caktuar qytetarësh të huaj bëjnë përjashtim nga detyrimi i regjistrimit pranë autoritetit përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin ku kanë vendosur vendbanimin¹⁰. Ligji përcakton disa kategori lejesh punësimi të cilat kanë karakteristika të ndryshme të lidhura me aktivitetin dhe personin e huaj, por megjithatë ligji i qëndron standarteve të vendosura me Ligjin nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, si dhe ligji nr. 13/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar”. Punësimi i shtetasve të BE dhe anëtarëve të familjes së tyre me shtetësinë e një vendi anëtar ose jo, ofrojnë mundësinë e punësimit në tregun e punës në Shqipëri, pa u kufizuar nga kuotat vjetore të punësimit, detyrimi për tu pajisur me leje pune apo certifikatë regjistrimi në punë.

Ndërkohë që ligji i ri (ligji 79/2021 “Për të huajt”), synon të krijojë lehtësi në fushën e lëvizjes së lirë të punëtorëve dhe imigrimit për motive punësimi, duke bashkuar dy lejet dhe procedurat për qëndrimin dhe punësimin e të huajve në vend në një leje unike. Edhe me ligjin e ri, shtetasit e BE dhe anëtarët e familjeve të tyre që nuk kanë shtetësinë e një Shteti Anëtar të BE apo Zonës Shengen, gëzojnë të drejtën e aksesit të lirë në tregun e punës në vend njësoj si shtetasit shqiptarë, pa u kufizuar nga kuotat për punësimin e të huajve apo detyrimi për t’u pajisur me leje unike për punësim apo ndonjë autorizim tjetër të ngjashëm me të¹¹. Kjo e drejtë del qartë në nenin 58, ku

⁷ Neni 17 1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.

⁸ Shfuqizoi Ligjin nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, si dhe ligji nr. 13/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar”

⁹ Neni 5 Të drejta dhe detyrime për të huajt. 1. Të huajt në Republikën e Shqipërisë gëzojnë të drejtat e parashikuara në Kushtetutë dhe në konventat ndërkombëtare të ratifikuara. 2. Autoritetet përgjegjëse gjatë vendimmarrjes në lidhje me të huajt zbatojnë dispozitat e këtij ligji në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara nga Kushtetuta dhe konventat, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. 3. I huaji zbaton Kushtetutën, ligjet në fuqi, si dhe vendimet e autoriteteve shtetërore gjatë hyrjes, qëndrimit dhe largimit nga territori i Republikës së Shqipërisë. 4. I huaji, lëvizja e të cilit kufizohet brenda një zone të caktuar, është i detyruar të lëvizë vetëm brenda kësaj zone.

¹⁰ Vendim Nr. 858, datë 29.12.2021 Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë, Aneksi Nr. 2.

¹¹ Neni 80/a. Nuk kanë nevojë për miratim për punësim nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive të huajt: a) shtetas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, anëtarët e familjes së shtetasve të SHBA-ve, shtetas të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të zonës Shengen dhe anëtarët e familjeve të tyre, që nuk janë shtetas të këtyre vendeve dhe që janë me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, shtetasit e njërit prej vendeve

“Lejet unike për punësim stinor” nuk kërkohen për të huajt nëse janë shtetas të një Shteti Anëtar të BE-së ose vendi Schengen dhe me qëndrim të ligjshëm në Shqipëri¹². Përmirësimet e ligjit synuan në një përafrim sa më të plotë me nenet 23 dhe 24 të Direktivës 2004/38/EC të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, mbi të drejtën e qytetarëve të BE-së dhe anëtarëve të familjes së tyre për të lëvizur dhe për të qëndruar lirshëm brenda territorit të Shteteve Anëtare duke ndryshuar Rregulloren (KEE) Nr. 1612/68/360/EEC, 75/34/EEC, 75/35/EEC, 90/364/EEC, 90/365/EEC, dhe 93/96/EEC.

3. Ligji Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” përcakton rregullat dhe mënyrën e funksionimit të sistemit publik të shërbimeve të punësimit, programet aktive dhe pasive të tregut të punës dhe organet përgjegjëse për menaxhimin e tyre. Në Nenin 3, pika 13, ligji përcakton me termin “punëkërkuës” çdo person me vendbanim në Republikën e Shqipërisë, në moshë pune, që regjistrohet si kërkues pune në strukturën rajonale/vendore dhe është i gatshëm për punë”, duke ofruar një interpretim të zgjeruar të nocionit mbi përfituesit e këtij ligji.

Neni 4 pika 2, përcakton si përfitues të ligjit shtetasit e BE-së që hyjnë dhe qëndrojnë në mënyrë të rregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë për qëllime punësimi, të cilëve u lind e drejta të përfitojnë nga shërbimet e ofruara në strukturën rajonale/lokale.

Neni 4/2. *Të drejtën e përfitimit të shërbimeve që ofrohen në strukturën rajonale/vendore e kanë të gjithë shtetasit e huaj dhe ata pa shtetësi, të cilët hyjnë e qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, për qëllime punësimi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt.*

Neni 4 Pika 3 nuk lë jashtë përcaktimit të tij dhe përfimet ligjore që kanë të huajt me statusin e refugjatit apo azilkërkuësit në RSH, dhe institucionet përgjegjëse për ofrimin e këtij shërbimi. Neni 4/3. *3. Të drejtën e përfitimit të këtyre shërbimeve e kanë edhe të huajt, të cilët kanë përfituar statusin e refugjatit, si dhe azilkërkuësit në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi për azilin. 4. Shërbimet e punësimit i ofrojnë mundësinë të huajve të pajisen me leje pune, në zbatim të legjislacionit në fuqi për të huajt.*

4. Ligji nr. 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës të Shqipërisë”, i ndryshuar, shtrin efektet e tij edhe ndaj shtetasve të huaj në përgjithësi, midis të cilëve shtetasve të BE dhe anëtarëve të familjeve të tyre njësoj si për shtetasit shqiptarë për çështje që lidhen me punësimin e tyre dhe marrëdhëniet e punës, të cilat nuk mbulohen nga kuadri ligjor në fuqi mbi të huajt¹³. Kodi garanton standarte dhe mundësi për qasje të barabartë dhe pa diskriminim (të drejtpërdrejtë ose indirekt) në tregun e punës, formimin profesional, lëvizjen e punëtorëve të BE (pavarësisht kombësisë), si dhe kushte të punës, njësoj si shtetasit shqiptarë. Sipas nenit 9 të këtij Kodi:

“1. Në ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, ndalohej çdo formë diskriminimi, e parashikuar në këtë Kod dhe në legjislacionin e posaçëm për mbrojtjen nga diskriminimi. Me “diskriminim” kuptohet çdo dallim, përjashtim, kufizim ose parapëlqim, që bazohet në gjininë,

të Ballkanit Perëndimor, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut, që janë me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët gëzojnë të drejtën e punësimit sikurse edhe shtetasit shqiptarë, përjashtuar rastet kur punësimi lidhet posaçërisht me pasjen e shtetësisë shqiptare sipas legjislacionit shqiptar. ...”

¹² Neni 58/6. Ky nen nuk zbatohet për shtetasit e vendeve të Bashkimit Evropian dhe zonës Shengen, si dhe për rastet kur zbatohet një regjim i posaçëm, i parashikuar me marrëveshje ndërkombëtare.

¹³ Ligji 108/2013 “Për të huajt” (neni 4).

Phone

+355 69 402 0057

Address

Rr.“Frederik Shiroka” Pallati “Alba”, Shk. 4, Ap. 7

Website

www.clr.al

racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, aftësinë e kufizuar, jetesën me HIV/AIDS, bashkimin ose përkatësinë në organizata sindikale, përkatësinë në një grup të veçantë, ose në çdo shkak tjetër, që ka si qëllim ose pasojë të pengojë ose të bëjë të pamundur ushtrimin e së drejtës për punësim dhe profesion, në të njëjtën mënyrë me të tjerët....”

Në respektim të standarteve të vendosura nga Kodi i Punës , ligji për të huajt e thekson parimin e barazisë midis shtetasve shqiptarë dhe të huaj në aksesin e tyre në punësim/tregun e punës përveç rasteve kur kërkohën kushte specifike që lidhen me pasjen e shtetësisë shqiptarë apo përdorimin e gjuhës shqipe. Neni 80/a “...shtetas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, anëtarët e familjes së shtetasve të SHBA-ve, shtetas të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të zonës Shengen dhe anëtarët e familjeve të tyre, që nuk janë shtetas të këtyre vendeve dhe që janë me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë, shtetasit e njërit prej vendeve të Ballkanit Perëndimor, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut, që janë me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët gëzojnë të drejtën e punësimit sikurse edhe shtetasit shqiptarë, përjashtuar rastet kur punësimi lidhet posaçërisht me pasjen e shtetësisë shqiptare sipas legjislacionit shqiptar. ...”

5. Funksionimi më i mirë i ligjit 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” ka kërkuar miratimin e 5 (pesë) vendimeve të Këshillit të Ministrave¹⁴ dhe 8 (tetë) programeve¹⁵, përfshirë edhe programet për të nxitur punësimin e personave të dalë të papunë për shkak të COVID-19.

Ndryshimi i strukturës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, si organ që kontrollon zbatimin e legjislacionit të punës në subjektet që ushtrojnë aktivitet në Republikën e Shqipërisë, me urdhër të Kryeministrit¹⁶ në 24 nëntor 2020, synonte të përmirësonte kushtet e punës të punëmarrësve dhe të krijonte lehtësi në përmbushjen e aktivitetit të tij.

¹⁴ Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.17 datë 15.01.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale”;

Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 348, datë 29.4.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet vetëpunësimit”;

Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.554, datë 31.07.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”;

Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 535 datë 08.07.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të punëve publike në komunitet”;

Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 608, datë 29.07.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes nëpërmjet punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19”.

¹⁵ Vendim Nr. 17, datë 15.1.2020 Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programeve të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit, formimit në punë dhe praktikave profesionale.

Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 161, datë 21.03.2018 “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”.

Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 816, datë 16.11.2016 “Për strukturën, kriteret e përzgjedhjes dhe marrëdhëniet e punës së punonjësve të njësisë përgjegjëse në autoritetet publike, në zbatim të ligjit nr. 60/2016, “për sinjalizimin dhe mbrojtjen e sinjalizuesve”.

¹⁶ Urdhri i Kryeministrit nr.172, datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”;

VKM - Vendim për përbërjen, kriteret dhe detyrat e bordit të administrimit të fondit social të punësimit dhe mënyrat e përdorimit të tij, datë 26.11.2020;

6. Ligji nr.18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”, i shtrin efektet e tij mbi fëmijët me shtetësi shqiptare, por edhe ata pa shtetësi ose me shtetësi të huaj, të cilët ndodhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë. Në rast migracioni, ligji parashikon mbrojtje të fëmijëve nëpërmjet një sistemi efektiv, sigurimin e zbatimit të parimeve të bashkëpunimit ndërsektorial dhe forcimin e aftësisë reaguese të sistemit për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga të gjitha format e dhunës. Ky ligj përcakton të drejtat, aksesin në të drejta, mbrojtjen që gëzon çdo fëmijë, mekanizmat përgjegjës që garantojnë realizimin me efektivitet të mbikëqyrjes, promovimin dhe mbrojtjen e këtyre të drejtave, si dhe përkujdesjen e posaçme për fëmijët, parashikimin e mekanizmave efikasë dhe mirëfunksionimin e institucioneve përgjegjëse të ngarkuara me marrjen e masave konkrete për promovimin, respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijës. Gjithashtu, ai parashikon të drejtën e jetës, emrit dhe kombësisë, e të qenit me prindërit dhe familjen, kthimit të sigurt, lirisë së shprehjes, arsimimit, kohës së lirë, kushteve të përshtatshme të jetesës dhe kujdesit shëndetësor, mbrojtjes nga dhuna, shfrytëzimi, përdorimi i drogës, trafikimi dhe konfliktet e armatosura, torturimi dhe arrestimi, si dhe të drejtën për kujdes alternativ. Në respektim të Konventës “Mbi aspekte civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës”

(neni 11), institucionet shtetërore në nivel qendror dhe vendor, ngarkohen me përgjegjësi për koordinimin dhe bashkëpunimin efektiv ndërmjet tyre, për zgjidhjen e problemeve të ndeshura dhe situatave në rastet e fëmijëve, në një kohë sa më të shkurtër¹⁷.

7. Ligji Nr. 9668, datë 18.12.2006 “Për emigrimin e shtetasve Shqiptarë për motive punësimi”, i ndryshuar me Ligjin 10 389, datë 03.03.2011, si dhe Strategjia për Riintegrimin e Shtetasve Shqiptarë të Kthyer 2010-2015 dhe Plani i saj i veprimit përbëjnë pjesë të rëndësishme në plotësimin e standarteve ligjore në mbrojtje të të drejtave të shtetasve shqiptarë të cilët kërkojnë të emigrojnë për arsye punësimi, kjo në bazë të marrëveshjeve të lidhura me qeveritë e vendeve pritëse. Qëllimi i këtyre instrumentave ligjorë është sigurimi i një kthimi të qëndrueshëm për emigrantët përmes mbështetjes së procesit të riintegrimit pavarësisht formës së kthimit. Ngritja dhe funksionimi i rrjetit të sporteleve të Migracionit është pjesë e rëndësishme e mekanizmit të mbështetjes për riintegrim, në kuadër të së cilës gjen zbatim edhe Urdhëri Nr.84, datë 06.06.2011 “Për formën, përmbajtjen e “Regjistrin për Emigrantët”.

Akte nënligjore

Në vijim të përmirësimit të kuadrit ligjor mbi rregullimin e statusit të shtetasve të huaj në Shqipëri janë nxjerrë akte nënligjore ndër të cilat përmendim:

- Krijimi i Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive (AKPA) (VKM Nr. 554, datë 31.4.2019) si një shërbim publik, në varësi të ministrit përgjegjës për punësimin dhe zhvillimin e aftësive, përmbledh të gjitha institucionet administrative dhe ofruese të shërbimeve të punësimit, të vetëpunësimit dhe të arsimit e formimit profesional. Veprimtaria e saj, mbështetet përtej VKM-së krijuese, në dispozitat e Ligjit nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”, Ligjin nr. 15/2017 “Për arsimin profesional në RSH”. Strukturat kryesore dhe kompetencat e tyre rregullohen në zbatim të Urdhrit të Kryeministrit nr. 172,

¹⁷ Ratifikuar me ligjin nr.9446, datë 24.11.2005 “Për ratifikimin e Konventës mbi aspekte civile të rrëmbimit ndërkombëtar të fëmijës”

datë 24.12.2019 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive”, si edhe të Urdhrave të Ministrit për çështjet e punësimit dhe aftësive, Për Organikat e Shkollave të Arsimit Profesional në zbatim të nenit 7, germa ç dhe neni 12, pika 4, e Ligjit nr. 15/2017, “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë”. AKPA si pjesë të misionit të saj ka të sigurojë përmbushjen e së drejtës së shtetasve shqiptarë, të huajve dhe personave pa shtetësi, të cilët kanë marrë statusin e refugjatit dhe azilkërkuesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, për t’u trajtuar me shërbime publike dhe programe të punësimit, vetëpunësimi dhe kualifikimet profesionale, për të siguruar një punë të përshtatshme, brenda dhe jashtë vendit, dhe për të ofruar shërbime të tilla.

- Vendim Nr. 151, datë 19.2.2020 “Për miratimin e planit kombëtar për integrimin evropian 2020–2022”;
- Vendim Nr. 91, datë 9.2.2022 “Për miratimin e planit kombëtar për integrimin evropian 2022–2024”; etj.

Strategji Kombëtare

Në vijim të nxitjes së punësimit dhe të rritjes së aftësive për punë, qeveria shqiptare ka hartuar strategjitë përkatëse dhe planin e veprimit. “Strategjia e punësimit dhe aftësitë” e zbatuar në vitet 2014-2018 përparoi pozitivisht, por tregues të veçantë kërkuan një ndërhyrje me anë të një plani veprimi më të detajuar.

Për këtë arsye, *Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2019-2022* (VKM-në Nr. 659/2019) dhe Plani i kërkuar të adresojnë të gjithë objektivat dhe reformat e nisura me qëllim finalizimin e tyre si dhe rishikimin e politikave të përcaktuara gjatë 4 viteve të zbatimit.

Qëllimi i saj: “Aftësi më të larta dhe punë më e mirë për të gjithë gratë dhe burrat”, i cili kërkon të arrihet nëpërmjet katër përparësive strategjike si:

- A. Nxitja e mundësive për punë të denjë, nëpërmjet politikave të frytshme të tregut të punës.
- B. Ofrimi i arsimit dhe formimit profesional cilësor për të rinjtë dhe të rriturit.
- C. Nxitja e përfshirjes sociale dhe kohezionit territorial.
- D. Fuqizimi i qeverisjes së tregut të punës dhe i sistemeve të kualifikimeve

Angazhimi i të gjithë aktorëve dhe mekanizmave institucionalë synon identifikimin dhe skicimin e politikave të duhura nxitëse të punësimit në vend dhe formimin profesional të forcës së punës, për hapjen e vendeve të punës cilësore dhe mundësi për aftësi gjatë gjithë ciklit të jetës. Në bazë të koordinimit dhe bashkëpunimit me institucione të linjës, strategjia përcakton masat që duhet të merren nga këto institucione, detajon buxhet për secilën masë dhe kontributin specifik të donatorëve, projektet që kanë marrë aprovimin për zbatim.

Aksesi i shtetasve të huaj në sektorin publik

Ligji nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, si dhe ligji nr. 13/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar”, ka përcaktuar të drejtën e punësimit të shtetasve të huaj në RSH si dhe paisjen e tyre me dokumentacioni përkatës.

Ligji e vë theksin tek kategoritë që përjashtohen nga detyrimi për pajisjen me leje pune apo certifikatë regjistrimi pune, duke shtuar kategoritë e të huajve që gëzojnë të drejta të barabarta me shtetasit shqiptarë në fushën e punësimit dhe të vetëpunësimit, si më poshtë:

- Shtetasit e vendeve të Bashkimit Evropian dhe zonës Shengen dhe anëtarët e familjes së shtetasve të një prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe zonës Shengen që

nuk janë shtetas të këtyre vendeve dhe që janë me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë;

- Shtetasit e njërës prej vendeve të Ballkanit Perëndimor, Bosnjë - Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut;
- Të huajt që punësohen në sektorë të ndryshëm, me qëllim rregullimin e pasojave dhe rimëkëmbjen nga fatkeqësi natyrore. Në këtë rast, deklarimi për punësimin e tyre bëhet në zyrën përkatëse të punësimit nga punëdhënësi ose vetë i huaji i vetëpunësuar apo investitor, pranë zyrës së punësimit në vendin ku kryhet aktiviteti.
- Është ndryshuar afati për qëndrimin e pjesëtarëve të ekuipazheve të anijeve, deri në 2 muaj brenda një viti, periudhë gjatë së cilës nuk pajisen me leje pune apo me certifikatë regjistrimi pune.

Në përkufizimin e ligjit, fusha e veprimit/punësimit të të huajve është mjaft e zgjeruar, duke lënë të kuptohet dhe ajo e *sektorit publik*, i cili kupton qeverisjen publike ku përfshihet administrata publike ose qeverisja publike të ndarë në qeverisje lokale (me të gjithë artikulacionet e saj, Prefekturë, Qark, Bashki) dhe administrata qendrore (ministritë e linjës, agjensi ose institucione qendrore).

Marrëdhëniet e punës të punonjësve të Administratës Publike rregullohen me ligje të veçanta e akte nënligjore të miratuara në bazë dhe në zbatim të tyre. Statusi i nëpunësit civil në RSH rregullohet nga Ligji Nr. 152/2013 *Për Nëpunësin Civil* (Ndryshuar me ligjin nr, 178/2014, datë 18.12.2014, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 211). Krahas tij, marrëdhëniet e punës në Administratën Publike rregullohen edhe nga dispozitat e Ligjit Nr. 7961/1995, "*Kodi i Punës*", i ndryshuar. Këto dispozita përcaktojnë procedura thelbësore për rekrutimin, masat disiplinore, dhe efektet e zbatimit të këtyre masave. Kodi i Punës e përkufizon të drejtën për punë si një marrëdhënie kontraktuale dhe në momentin e lidhjes së kontratës individuale apo kolektive, krijon pozita të barabarta vendimmarrjeje edhe pse nga praktika pozitat e punëmarrësit me ato të punëdhënësit nuk janë të tilla.

Në rastin e punësimeve në administratën publike, ligji për "*Nëpunësin civil*" ka përcaktuar si kërkesë të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil, se një kandidat duhet të plotësojë kërkesa të përgjithshme ndër të cilat e para është: *a) të jetë shtetas shqiptar*; (neni 21). Këtë nen thërret dhe vetë ligji "*Për të Huajt*" kur përcakton si kusht përjashtimi nga detyrimi për pajisje me leje pune dhe certifikatë regjistrimi pune të gjithë të huajt, shtetas të një prej vendeve anëtare të Bashkimit Europian edhe zonës Shengen, me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët nuk mund të përfitojnë dot nga kjo e drejtë në rastet kur *punësimi lidhet posaçërisht me pasjen e shtetësisë shqiptare, sipas legjislacionit shqiptar* (Neni 72, pika a). Në logjikën e ligjit për Nëpunësin Civil dhe Kodin e Punës nuk përjashtohet mundësia e punësimit të shtetasve të huaj si në sektorin e vetëpunësimit dhe atë të punësimit me kontratë por që për administratën shtetërore, marrëdhëniet e punës kalojnë mbi kushte specifike të përcaktuara me ligje të veçanta të cilat e lidhin këtë punësim me mbajtjen e shtetësisë shqiptare.

B. Lëvizja e punonjësve brenda BE (Regulation (EEC) 1612/68)

Përsa i përket lëvizjes së shtetasve të huaj në Republikën e Shqipërisë, një sërë ligjesh kanë patur në fokusin e tyre rregullimin e statusit të të huajve. Respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, kuadrit ligjor ndërkombëtar dhe përafrimit të tij me normativën Europiane përçon të gjithë përmbajtjen e tij:

1. Ligji nr. 79/2021 “Për të Huajt¹⁸” prek të gjithë shtetasit e huaj të cilët hyjnë ose synojnë të hyjnë në Republikën e Shqipërisë, me qëllim qëndrimin, kalimin transit, punësimin, studimin, si dhe në rastet kur dalin nga Republika e Shqipërisë (neni 1). Të drejtat e tyre garantohen nga Kushtetuta e RSH dhe Konventat Ndërkombëtare të ratifikuara (Neni 5¹⁹).

2. Ligji nr.121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, në mënyrë të përmbledhur përcakton kushtet dhe procedurat për dhënien dhe refuzimin e azilit, të drejtat dhe detyrat e azilkërkuesve, refugjatëve dhe personave nën mbrojtje të përkohshme dhe plotësuese, të drejtën për bashkim familjar, aksesin në shërbime dhe integrimin e refugjatëve në Shqipëri.

Ligji i jep një rëndësi të madhe mbrojtjes së të drejtave të fëmijëve të pashoqëruar, që hyjnë në Shqipëri si azilkërkues, duke iu caktuar një kujdestar ligjor dhe shqyrtimin me përparësi të kërkesës së tyre. Si përfundim, ligji për emigrimin parashikon se fëmijët migrantë duhet të kthehen në mënyrë të sigurt²⁰.

3. Përpos kësaj, Vendimi nr.111, datë 6.3.2019 të Këshillit të Ministrave “Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës së pashoqëruar” ka parashikuar në mënyrë të hollësishme procedurat për fëmijët e kthyer nga migracioni, duke e trajtuar situatën e tyre mbështetur në parimin e interesit më të lartë të fëmijës²¹.

Axhenda Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve 2016-2020, parashikonte eliminimin e dhunës ndaj fëmijëve, ngritjen e shërbimeve të përshtatshme për ta dhe qeverisjen e të drejtave të tyre.

4. Ligji nr.8389/1998 “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar (nenet 6 & 9) ka parashikuar shprehimisht rregullat për mënyrën e marrjes së shtetësisë shqiptare, nëpërmjet lindjes, natyralizimit, pas 5 vitesh qëndrimi të vazhdueshëm në Shqipëri dhe, birësimin nga qytetarët shqiptarë.

¹⁸ Shfuqizoi Ligjin nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, si dhe ligji nr. 13/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar”

¹⁹ Neni 5 Të drejta dhe detyrime për të huajt. 1. Të huajt në Republikën e Shqipërisë gëzojnë të drejtat e parashikuara në Kushtetutë dhe në konventat ndërkombëtare të ratifikuara. 2. Autoritetet përgjegjëse gjatë vendimmarrjes në lidhje me të huajt zbatojnë dispozitat e këtij ligji në përputhje me të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara nga Kushtetuta dhe konventat, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara. 3. I huaji zbaton Kushtetutën, ligjet në fuqi, si dhe vendimet e autoriteteve shtetërore gjatë hyrjes, qëndrimit dhe largimit nga territori i Republikës së Shqipërisë. 4. I huaji, lëvizja e të cilit kufizohet brenda një zone të caktuar, është i detyruar të lëvizë vetëm brenda kësaj zone.

²⁰ Neni 16 i ligjit nr.121/2014.

²¹ Gjithashtu, mbështetur edhe në aktet nënligjore si udhëzimi nr.10, datë 25.2.2015 të ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, ministrit të Arsimit dhe Sporteve, ministrit të Shëndetësisë dhe ministrit të Punëve të Brendshme, në urdhrin nr.643, datë 17.12.2013, të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit “Për marrjen e masave për ripranimin në Shqipëri të të miturve të pashoqëruar, verifikimin dhe fillimin e hetimeve në rastet kur prindërit apo kujdestarët ligjorë nuk përmbushin detyrimet ligjore”, udhëzimin nr.332/3, datë 7.3.2014 të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Shërbimit Social Shtetëror “Për marrjen e masave për pritjen dhe trajtimin social të të miturve të pashoqëruar që kthehen/ripranohen nga vendet e bashkimit Evropian”, janë parashikuar veprimet konkrete, institucionete përgjegjëse dhe format e bashkëpunimit, bashkërendimin dhe koordinimit për mbrojtjen e fëmijëve, shërbimet cilësore për mbrojtjen e fëmijëve, shërbimet e përshtatshme për fëmijët, si dhe pjesëmarrja e fëmijëve në vendimmarrje.

5. Ligji nr.9861/2008 “Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror”, parashikon procedurat për kalimin e kufirit, rolet dhe detyrat e Policisë Kufitare, procedurat që duhen ndjekur për emigrantët dhe migrantët, që hyjnë ose qëndrojnë në mënyrë të parregullt, duke përfshirë azilkërkesit, viktimat e trafikimit dhe fëmijët e pashoqëruar. Legjislacioni në fuqi për kufirin, parashikon procedurën për identifikimin dhe ofrimin e ndihmës për fëmijët e pashoqëruar nga Shqipëria, në situatë kufitare. Ky ligj parashikon disa masa mbrojtëse dhe sigurie për këtë grup të veçantë fëmijësh, të tilla si: përdorimi i paraburgimit si masë e fundit, gjurmimi i familjes, identifikimi dhe referimi tek autoritetet përgjegjëse²².

- Vendimi nr.400, datë 19.6.2019, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e strategjisë kombëtare për migacionin dhe të planit të veprimit 2019-2022”. Me anë të këtij vendimi, qeveria shqiptare synon: “Qeverisjen e efektshme të migracionit në Shqipëri për të trajtuar sfidat që rezultojnë nga lëvizjet migratore dhe për të rritur ndikimin e migracionit tek zhvillimi në të mirë të migrantëve dhe shoqërisë”. Realizimi i këtij objekti do të mundësohet nëpërmjet katër prioritetëve: 1. Garantimi i qeverisjes strategjike të migracionit në Shqipëri; 2. Garantimi i migracionit të sigurt dhe të rregullt nga, përmes, dhe drejt Shqipërisë; 3. Zhvillimi i politikave të efektshme për migracionin për motive punësimi duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit tek zhvillimi socio-ekonomik kombëtar/lokal; 4. Promovimi dhe mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integritetit të tyre.

- Vendim Nr. 858, datë 29.12.2021 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”;

- Vendim Nr.243, datë 20.4.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”;

- Vendimi nr.499, datë 29.8.2018, i Këshillit të Ministrave “Për miratimin e procedurave standarde të veprimit për mbrojtjen e viktimave dhe viktimave të mundshme të trafikimit”;

- Vendimi nr.111, datë 2019 i Këshillit të Ministrave “Për procedurat dhe rregullat për kthimin e riatdhesimin e fëmijës së pashoqëruar”;

- Udhëzimi nr.293/2015 i Ministrit të Brendshëm "Për procedurat e trajtimit të të huajve me qëndrim të parregullt në Shqipëri";

- Urdhri nr.1146/2014 i Ministrit të Brendshëm “Për disa shtesa dhe ndryshime në urdhrin nr.851/2009 'Për miratimin e procedurave standarde të punës për kufirin dhe migracionin’; etj...

- A u garantohen të njëjtat të drejta punëtorëve migrantë të BE-së në punësim me ata vendas?

Legjislacioni shqiptar kujdeset të mënjanojë të gjitha trajtat dhe format e diskriminimit në bazë të kombësisë për emigrantët e huaj shtetas të BE apo të vendeve Schengen ose ata që kanë statusin e azilkërkesit apo refugjatit, pa shtetësi në krijimin e kushteve të barabarta për

²² Neni 36, përcakton të drejtën e policisë për të kryer kontrole të hollësishme, në rast të dyshimeve për larigimin e një fëmije nga kujdestaria e prindërve ose kur fëmija është i pashoqëruar.

punësim, kushte të barabarta pune, pagë të barabartë për punë të barabartë me shtetasit shqiptarë apo dhe raste të pushimit nga puna. Në përputhje me detyrimet e integritimit evropian në kuadër të kapitullit 2, synohet të krijohen mundësi për qasje të barabartë dhe pa diskriminim në tregun e punës, formimin profesional, lëvizjen e punëtorëve të BE, si dhe kushte të punësimit, njësoj si shtetasit shqiptarë.

Krahas aksesit në punësim, Ligji nr. 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar, si dhe ligji nr. 13/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin 108/2013 “Për të huajt”, i ndryshuar”, garanton për shtetasit e huaj, e konkretisht shtetasit e vendeve të Bashkimit Evropian dhe zonës Shengen të cilët përjashtohen nga përcaktimet e pikës 1²³ të nenit 71 se gëzojnë të drejta të barabarta me shtetasit shqiptarë në fushën e punësimit dhe të vetëpunësimit. Ky ligj përcakton më tej se, këta shtetas (shtetas të një prej vendeve anëtare të Bashkimit Evropian edhe zonës Shengen) përjashtohen nga detyrimi për pajisje me leje pune dhe certifikatë regjistrimi pune, nëse janë me qëndrim të ligjshëm në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ata gëzojnë të drejtën e punësimit, sikurse edhe shtetasit shqiptarë me përjashtim të rasteve kur punësimi lidhet posaçërisht me *pasjen e shtetësisë shqiptare*, sipas legjislacionit shqiptar. Deklarimi për punësimin e tyre bëhet në zyrën përkatëse të punësimit nga punëdhënësi ose vetë i huaji i vetëpunësuar apo investitor, pranë zyrës së punësimit në vendin ku kryhet aktiviteti (Neni 72/a) Neni 76 i ligjit garanton instrumentat e nevojshme për monitorimin e kushteve të punës dhe punësimit të të huajve të cilat duhet të jenë të barabarta me vendasit, të cilat mund të shkojnë deri në revokimin e lejes së punë. Në këtë mënyrë kërkohet të eliminohen të dyja format e diskriminimit (të drejtpërdrejtë dhe tërthortë)²⁴. Neni 74, pika 7/b²⁵ e vë theksin në kërkesën që në të njëjtin pozicion pune punonjësit e huaj duhet të punësohen me të njëjtat kushte si punonjësit shqiptarë. Ligji vazhdon dhe më tej kur përcakton se, vendet e lira të punës bëhen publike sipas në procedure të caktuar, afati kohor dhe profili të përshtatshëm sipas një rendi të caktuar: a) punëkërkues të papunë shqiptarë; b) të huaj, anëtarë të familjes së shtetasve shqiptarë; c) shtetas të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe të zonës Shengen dhe anëtarët e familjes së tyre, që nuk janë shtetas të këtyre vendeve dhe janë me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë; ç) shtetas të vendeve të Ballkanit Perëndimor, Bosnjë-Hercegovinës, Malit të Zi, Kosovës, Serbisë dhe Maqedonisë së Veriut; d) anëtarë të familjes së të huajit me qëndrim të ligjshëm në Republikën e Shqipërisë; dh) shtetas të vendeve me të cilat Republika e Shqipërisë ka nënshkruar marrëveshje punësimi dy apo shumëpalëshe; e) të huaj që gëzojnë përparësi për përfshirje në tregun shqiptar të punës, sipas dispozitave të këtij ligji²⁶. Ligji për të huajt vendos standarte mbi kushtet e punësimit, pagën, procedurën e aplikimit për vend punë të cilat duhet të jenë të barabarta me shtetasit shqiptarë²⁷ (Neni 75 pika e).

²³ Neni 71/1. I huaji mund të punësohet në Republikën e Shqipërisë duke u pajisur me leje pune, apo me certifikatë regjistrimi pune, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë ligj, me marrëveshje ndërkombëtare të njohura nga Republika e Shqipërisë apo qëndrim të njëanshëm të shprehur me vendim të Këshillit të Ministrave.

²⁴ Neni 76. Revokimi i miratimit për punësim nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive Miratimi për punësimin e një të huaji mund të revokohet në rast se i huaji është punësuar në kushte më pak të favorshme se shtetasit shqiptarë, si dhe në rastin kur nuk plotësohen më kërkesat e përcaktuara në nenet 74 dhe 75 të këtij ligji.

²⁵ Neni 74. 7. Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive jep miratimin e saj nëse: a) aplikimi është brenda kuotave vjetore të miratuara, në zbatim të këtij ligji; b) punonjësit e huaj nuk janë punësuar në kushte më pak të favorshme se punonjësit shqiptarë në të njëjtin pozicion. Nga shqyrtimi i informacionit lidhur me pagat, orët e punës dhe kushtet e tjera të punësimit, ato janë në përputhje me legjislacionin shqiptar të punës; c) plotësohen kërkesat e neneve të posaçme që lidhen me punësimin; ç) asnjë punonjës nga kategoritë e përcaktuara në pikën 9 të këtij neni nuk është i disponueshëm për atë vend pune.

²⁶ Neni 74 pika 9, Ligji Nr. 79/2021

²⁷ Neni 75 pika e) pagat e marra nga punëtorët kanë qenë nën nivelin e përcaktuar nga marrëveshjet kolektive;

Krahas aspekteve të tjera në ligj përcaktohet detyrimi i autoriteteve të ndryshme shtetërore, publike qendrore dhe lokale të ofrojnë informacionin e nevojshëm për të huajt në fushën e punësimit, shëndetësi, sigurime etj²⁸.

Në një frymë gjithëpërfshirjeje është orientuar edhe Ligji Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” cili garanton të drejta të barabarta si për shtetasit shqiptarë ashtu dhe shtetasit e huaj me qëndrim të rregullt në territorin shqiptar. Ky ligj në nënin 4 të tij garanton të drejtën e tyre për të përfituar shërbime të ofruara në strukturën rajonale/lokale. Roli që Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive (AKPA), luan ka në fokus sigurimin dhe përmbushjen e të drejtës së shtetasve shqiptarë, të huaj dhe pa shtetësi të huaj, me statusin e refugjatit si dhe të azilkërkuesit në territorin e Republikës së Shqipërisë, për t’u trajtuar me shërbime dhe programe publike të punësimit, të vetëpunësimit dhe të kualifikimeve profesionale, me qëllim gjetjen e një pune të përshtatshme, brenda dhe jashtë vendit, si dhe ofrimin e këtyre shërbimeve.

Ndër përgjegjësitë e saj, rradhiten:

- a) të garantojë nivelin e cilësisë së shërbimeve të ofruara për punësimin, vetëpunësimin dhe arsimin e formimin profesional, nëpërmjet monitorimit dhe vlerësimit;
- b) të organizojë punën për administrimin dhe zbatimin e programeve aktive e pasive të tregut të punës;
- c) të organizojë punën për administrimin e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional (AFP), sipas legjislacionit në fuqi për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë;
- d) të organizojë punën për menaxhimin, ndjekjen dhe kontrollin e drejtorive rajonale, të zyrave vendore dhe të ofruesve publikë të arsimit e formimit profesional;
- e) të sigurojë se funksionet e lidhura me planifikimin, zbatimin, kontabilitetin dhe raportimin financiar për drejtoritë rajonale, zyrat vendore dhe ofruesit publikë të arsimit dhe formimit profesional, kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Kjo agjenci ofron një informim të gjithë përfituesve të shërbimeve të saj mbi llojet e shërbimeve dhe garanton lehtësimin e tyre për të gjithë subjektet e interesuara ku bëjnë pjesë si shtetasit shqiptarë ashtu dhe ata të huaj. Ajo punon në koordinim me instucione të tjera publike në ofrimin e një informacioni sa më të gjerë për të gjithë shtetasit e huaj dhe shqiptarë.

Në ofrimin e garancive ligjore, larg diskriminimit, legjislacioni shqiptar nëpërmjet ligjit Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 dhe ligjin 41/2017) (Neni 21) përcakton kërkesat e përgjithshme për pranimin në shërbimin civil. Sipas ligjit, në shërbimin civil, një kandidat duhet të plotësojë kërkesat si më poshtë: a) të jetë shtetas shqiptar; b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar; c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur; ç) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse; d) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje; dh) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji; e) të plotësojë kërkesat e posaçme për nivelin e arsimit, përvojës dhe kërkesat e tjera të posaçme për kategorinë, klasën, grupin dhe pozicionin përkatës.

Si një ligj specifik i cili rregullon marrëdhëniet e punës në administratën civile ai përcakton kërkesa specifike për punëmarrësin (shtetas shqiptarë ose shtetas në posedim të një dokumenti të shtetësisë shqiptare). Midis kushteve përjashtuese krahas mbajtjes së shtetësisë për t’u punësuar në administratën publike është edhe përdorimi i gjuhës shqipe, në respektim të Kushtetutës së RSH e cila përcakton se “Gjuha zyrtare në Republikën e Shqipërisë është shqipja” (neni 14 pika 1) dhe quan detyrë të shtetit “mbrojtjen e trashëgimisë kombëtare, kulturore dhe kujdesin e veçantë për gjuhën shqipe” (neni 59, pika 1g). Në këtë rast mund të

²⁸ Neni 4 Ligj Nr. 108/2013 “Për të huajt”, “Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve që kërkojnë të hyjnë dhe të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë, është përgjegjës për dhënien e informacionit për të huajt e pajisur me leje qëndrimi”.

flasim për një kufizim të mundësive të punësimit për të huajt e cila varet nga kushtet specifike të vendosur me ligj. Nuk kemi të bëjmë në këtë rast me diskriminim pasi kushtet konkrete të caktuara në ligjin “Për Nëpunësin civil” përcaktojnë rregullat bazë për punësimin në administratë, kushte të njohura gjithashtu në Kushtetutë dhe ligje të tjera organike. Në garantimin e mosdiskriminimit, ligjet e sipërcituara kujdesen të eliminojnë çdo formë të diskriminimit që ka të bëjë me kushtet e punësimit, përzgjedhjen e kandidatëve për punë të caktuara, kushtet e punës dhe të drejtat e prejdardhura nga marrëdhëniet e punës, edukimi, trajnimi i vazhdueshëm, promovimi dhe ngjitja në pozicionin e punës, mbarimi i kontratës së punës. Në rast të kushteve diskriminuese në lidhjen e kontratës, ajo do të quhet nul. Kodi i Punës përcakton kushtet e punësimit për shtetasit e huaj dhe ato pa shtetësi me qëndrim të rregullt në territorin shqiptar, kjo në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore të cilat ndalojnë diskriminimin direkt dhe atë indirekt. Ky rregull vlen edhe për shtetasit e BE-së që kërkojnë të punësohen në Shqipëri. Ligji nr. 10221/2010 “Për mbrojtjen kundër diskriminimit” është akti ligjor kryesor i legjislacionit shqiptar kundër diskriminimit. Po ashtu, të drejtat e migrantëve garantohej shprehimisht në disa akte ligjore dhe vendime të Këshillit të Ministrave, si edhe në kuadrin rregullator në zbatim të këtyre akteve ligjore.

Garancitë e legjislacionit për punëtorët e BE-së

a- shërbimet mjekësore

1. Ligji nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”, synon përmirësimin e kuadrit ligjor në fushën e përkujdesit social, zgjerimin e ndihmës së ofruar për shtetasit shqiptarë dhe të huaj, përtej formave të aplikuara në legjislacionin e vjetër (siç ishte psh, ndihma në të holla). Në veçanti, ky ligj parashikon një gamë të gjerë shërbimesh të reja, duke përfshirë: shërbimet parashoqërore, shërbimet në qendrat e komunitetit, shërbimet rezidenciale (duke përfshirë strehimin), shërbimet sociale në raste emergjence, kujdes alternativ për fëmijët pa kujdes prindëror, këshillim dhe nëpërmjet internetit dhe telefonit, si dhe shërbime të tjera të specializuara. Ligji përmend drejtpërdrejt ndër përfituesit e shërbimeve të sipërpërmendura shtetasit e huaj, personat pa shtetësi dhe refugjatët ose përfituesit e mbrojtjes shtesë.
2. Vendim Nr. 307, datë 21.5.2014 *Për regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor (I ndryshuar me Vendimin Nr. 74, datë 7.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 307, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, ‘Për regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor’)* I përditësuar, përcakton rregullat mbi regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga sigurimi i detyrueshëm midis të cilëve edhe shtetasit e huaj përsa kohë ata janë subjekte të sigurimit shëndetësor të detyrueshëm nga shteti shqiptar.
3. VKM Nr. 632, datë 15.7.2015 “Për disa Ndryshime dhe Shtesa në Vendimin nr. 108, datë 9.2.2011, të Këshillit të Ministrave, “Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë”.
4. Vendim Nr. 185, datë 2.4.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së realizimit të kontrollit mjekësor bazë për shtetasit e moshës 35-70 vjeç” (Ndryshuar me VKM nr.721, datë 12.10.2016); etj...

Sipas ligjit, kategoritë përfituese nga skema e sigurimeve të detyrueshme të kujdesit shëndetësor janë: Çdo shtetas që paguan kontribut për sigurim shëndetësor, ose për të cilin paguan shteti, është i siguruar dhe përfiton nga skema e sigurimeve shëndetësore.

Phone

+355 69 402 0057

Address

Rr.“Frederik Shiroka” Pallati “Alba”, Shk. 4, Ap. 7

Website

www.clr.al

Karta e Shëndetit është dokumenti i vetëm që vërteton se personi është i siguarur në skemën e sigurimeve shëndetësore. Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor dhe pagesa e kontributeve përkatëse janë të detyrueshme për të gjithë personat ekonomikisht aktivë, me banim të përhershëm në Shqipëri, si: të punësuarit; personat e vetëpunësuar; punonjësit e papaguar të familjes; persona të tjerë ekonomikisht aktivë.

Sigurimi i detyrueshëm shëndetësor mbulon, gjithashtu, kategoritë e mëposhtme të personave ekonomikisht joaktivë, pagesa e kontributeve të të cilëve financohet nga Buxheti i Shtetit ose burime të tjera të përcaktuara me ligj: personat që përfitojnë nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore; personat që përfitojnë ndihmë ekonomike ose pagesën për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin përkatës; personat e regjistruar si të papunë-punëkërkues në Shërbimin Kombëtar të Punësimit; shtetasit e huaj azilkërkues në Republikën e Shqipërisë; fëmijët nën moshën 18 vjeç; nxënësit e studentët nën moshën 25 vjeç, me kusht që të mos kenë të ardhura nga veprimtari ekonomike; kategori personash që përcaktohen me ligje të veçanta; viktimat e trafikimit, sipas identifikimit të bërë nga strukturat e Ministrisë të Punëve të Brendshme.

» Personat e siguarur vullnetarisht

Cfarë përfitojnë?

Sigurimi i detyrueshëm financon paketat e shërbimeve të sigurimit të detyrueshëm, ku përfshihen: Vizitat mjekësore pa pagesë në institucionet shëndetësore publike, që financohen nga sigurimi shëndetësor dhe në respektim të sistemit të referimit; Vizitën falas në banesë – kur gjendja shëndetësore e të sëmurit nuk mundëson paraqitjen në institucionin shëndetësor; Ekzaminimet mjekësore në institucionet shëndetësore publike; Trajtimet mjekësore pa pagesë në spitalet publike; Shërbimet e paketave shëndetësore në institucionet shëndetësore private të kontraktuara me Fondin e Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor; Rimbursimi i plotë ose i pjesshëm i barnave të Listës së Barnave të Rimbursueshme në varësi të kategorisë. Më konkretisht për barnat, personat e siguarur, ose nuk paguajnë fare ose kanë një pagesë të pjesshme që shkon deri në 50 % (për qind) të çmimit të barnave, por jo më shumë.

Kategoritë si: pensionistë, invalidë të plotë, fëmijë 0 – 12 muaj, të sëmurë me CA, TBC, të verbër përfitojnë falas alternativën e parë të çdo bari të përfshirë në listë. Kategoritë si: veteran dhe invalidë të luftës, përfitojnë falas në masën 100 % të gjitha barnat e listës së rimbursueshme, si dhe të gjitha barnat e tjera të regjistruara në Republikën e Shqipërisë.

Legjislacioni i lartpërmendur ofron një kornizë të qëndrueshme ligjore që siguron mbrojtjen e shtetasve të huaj në Shqipëri por edhe shtetasve shqiptarë të kthyer nga emigracioni. Përafrimi i kuadrit ligjor me Acquis e BE-së ka evidentuar domosdoshmërinë e përcaktimit ligjor për shërbime publike ndaj të huajve.

Ligji 79/2021 “Për të huajt” ka përcaktuar në nenin 75/ë se, *Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive*, ndër të tjera, refuzon të japë miratimin për punësimin e një të huaji kur punëdhënësi ose punëmarrësi i huaj nuk ka shlyer detyrimet për taksat dhe kontributet e sigurimeve shoqërore. Në këtë mënyrë ligji përcakton detyrimin që ka institucioni të monitoruar plotësimin e standarteve ligjore nga aplikuesit për leje punësimi, aq më shumë kur përfituesit janë shtetas të huaj, pa shtetësi apo azilkërkues etj.

Në rastin kur të huajt nuk arrijnë të vërtetojnë se qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në territorin e Shqipërisë nuk mund të përfitojnë nga shërbimet publike nga organizatat dhe administrata vendore, kompanitë e interesit publik dhe institucionet e sigurimeve shoqërore. Nga ky përcaktim bëjnë përjashtim vetëm shërbimet mjekësore në situata të emergjencave mjekësore.

të ofruara nga spitalet dhe qendrat shëndetësore (Neni 133). Ligji përcakton ndër detyrimet e shumta për punëdhënësin që të paguajnë çdo taksë dhe kontribut shoqëror të prapambetur, përfshirë edhe gjobat administrative përkatëse të të huajit, të punësuar në mënyrë të paligjshme prej tyre (Neni 134 /e). Një tjetër garanci ligjore për të huajt lidhet me Nenin 48/2 që përcakton se ripërtërimi i lejes së qëndrimit *au pairs* deri në 6 muaj vetëm në rastin kur përmbushen detyrimet që lidhen me sigurimet shoqërore, taksat, të drejtat e punës ose kushtet e punës. Në rastin e përfitimit të lejes së përhershme të qëndrimit kjo realizohet nëse punëdhënësi apo i vetëpunësuari plotëson kërkesat e Nenit 87 pikat c dhe ç²⁹. Standarte të një qëndrimi të rregullt dhe të sigurtë në territorin e RSH përveç shtetasve të huaj kërkohen edhe për familjarët e të huajve të cilat duhe të plotësojnë kushtet: “b) disponon dokumentacion që provon se ka siguruar strehimin e rregullt në Republikën e Shqipërisë; c) provon se disponon burime të qëndrueshme financiare, që janë të mjaftueshme për mbajtjen e tij dhe të pjesëtarëve të familjes së tij; ç) disponon sigurimin shëndetësor, që mbulon të gjitha rreziqet sipas legjislacionit në fuqi;³⁰”.

Legjislacioni në fuqi përcakton shërbime të përkujdesit shëndetësor për të gjithë shtetasit e huaj në territorin e RSH. Në pikën 1 të Vendimit Nr. 307, datë 21.5.2014 përcaktohen si të siguruar të gjithë personat ekonomikisht aktivë, me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë³¹. Më tej vendimi përcakton se është Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor që regjistron të gjithë personat e siguruar në sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor, për të evidentuar të gjithë personat e siguruar në mënyrë të detyrueshme dhe veçoritë e sigurimit të tyre (masa e kontributit, kohëzgjatja e sigurimit etj.) (pika 2). Sipas vendimi janë autoritet përgjegjëse të përcaktuara të cilat japin informacionin sipas kategorive të të siguruarve, në rastin konkret Ministria e Punëve të Brendshme³². Vendimi shkon më tej duke përcaktuar mjetet për identifikimin e personit të siguruar në *skemën e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor*, pajisjen e tij/saj me kartën e shëndetit dhe karakteristikat e veçanta që ka kjo kartë për të huajt³³.

²⁹ Neni 87, ligji 79/2021 c) provon se ka të mbuluar sigurimin shëndetësor sipas sistemit të sigurimit shëndetësor për shtetasit shqiptarë në Republikën e Shqipërisë; ç) ka të garantuar strehim të përshtatshëm për vete dhe anëtarët e familjes së tij në Republikën e Shqipërisë;

³⁰ Neni 93 pika b, c, ç, Ligji 79/2021

³¹ Vendim Nr. 307, datë 21.5.2014 “Për regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor” (I ndryshuar me Vendimin Nr. 74, datë 7.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për një ndryshim në Vendimin Nr. 307, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, ‘Për regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor’”) I përditësuar. 1. Të siguruar në skemën e sigurimit të detyrueshëm shëndetësor quhen personat ekonomikisht aktivë, me banim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, që paguajnë kontributin e detyrueshëm të sigurimit shëndetësor, personat ekonomikisht joaktivë, pagesa e kontributeve të të cilëve financohet nga buxheti i shtetit ose burime të tjera, të përcaktuara me ligj, si dhe personat e siguruar në mënyrë vullnetare.

³² Pika 4 Vendimi Nr. 307, datë 21.5.2014. a) Ministria e Punëve të Brendshme është përgjegjëse për dhënien e informacionit për kategorinë e shtetasve të huaj azilkërkues në Republikën e Shqipërisë; f) Autoriteti shtetëror qendror përgjegjës për trajtimin e të huajve që kërkojnë të hyjnë dhe të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë, është përgjegjës për dhënien e informacionit për të huajt e pajisur me leje qëndrimi.

³³ Vendimi Nr. 307, datë 21.5.2014. Pika 8. *Identifikimi i personave të siguruar në skemën e sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor bëhet me anë të dokumentit të identifikimit, nëpërmjet shërbimit të regjistrimit elektronik të të siguruarve të fondit ose portalit e-Albania*; 9. Karta e shëndetit është dokumenti që vërteton se mbajtësi i saj është person i siguruar, sipas ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; 10. Karta e shëndetit është personale dhe e patjetërsueshme. Ajo përmban numrin e identitetit të personit, i cili është edhe numri i sigurimit shëndetësor të detyruar. Për të huajt, si numër i sigurimit shëndetësor të detyruar do të shërbejë numri i lejes së qëndrimit ose i lejes provizore të qëndrimit.

Vendimi Nr. 185, datë 2.4.2014 pika 2³⁴ garanton për të gjithë shtetasit e grupmoshës 35-70 vjeç, me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, përfitimin nga programi kombëtar i kontrollit mjekësor bazë pa pagesë.

Vendimi 858, datë 29.12.2021 përcakton detyrimin për njoftim të strukturave të specializuara të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për të marrë së bashku masat e duhura, nëse i huaji nuk është i pajisur me kartelë, sipas legjislacionit në fuqi.

Ligji Nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit” në përcaktimin e tij në nenin 11 programet e nxitjes së punësimit³⁵ si dhe programet pasive të tregut të punës të cilat përfshijnë të ardhurat nga pagesa e papunësisë³⁶ (neni 13). Përfitues të këtyre programeve janë edhe shtetasit e huaj dhe ata pa shtetësi, të cilët hyjnë e qëndrojnë në mënyrë të ligjshme në territorin e Republikës së Shqipërisë, për qëllime punësimi, të huajt, të cilët kanë përfituar statusin e refugjatit, si dhe azilkërkuesit në Republikën e Shqipërisë në përputhje me legjislacionin në fuqi për të huajt dhe azilin. Shërbimet e punësimit u ofrojnë mundësinë të huajve të pajisen me leje pune, në zbatim të legjislacionit në fuqi për të huajt (neni 4). Përgjegjëse është Ministria e Punës e cila rregullon dhe ndërhyr në punësimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë, sipas legjislacionit në fuqi për të huajt dhe mbështet punësimin e shtetasve shqiptarë jashtë vendit (neni 5 pika d) sipas politikave të punësimit të zbatueshme nga ajo dhe strukturave rajonale/vendore në varësi të saj (neni 5 parag. 2). Standartet e përcjella nga ligji “Për nxitjen e punësimit” garantojnë mbrojtje të të drejtave si të shtetasve shqiptarë edhe atyre të huaj (neni 9), ofrojnë programe aktive të punësimit, të nxitjes së punësimit; e të formimit profesional (neni 6) nga struktura rajonale/vendore (neni 7) të cilat kanë detyrimin të sigurojnë dhe të ofrojnë informacion për kërkesën e ofertën në tregun e punës, si për punëkërkuesit, ashtu dhe për punëdhënësit (neni 8).

Sipas Kushtetutës, kreu i lirive dhe të drejtave sociale, ekonomike dhe kulturore, garanton të drejtën e punës së ligjshme dhe të mbrojtjes shoqërore të punës (Neni 49). Neni 50 i Kushtetutës, garanton të drejtën e të punësuarve që të bashkohen lirisht në organizata sindikale për mbrojtjen e interesave të tyre të punës, e si pasojë të ushtrojnë të drejtën e grevës dhe që kufizohet vetëm me ligj (Neni 51). Liria sindikale është e përcaktuar në nenin 50 të Kushtetutës së RSH.

Organizimi dhe veprimi sindikal është i lirë në përputhje me Kodin e Punës i cili duke garantuar barazi në trajtim midis shtetasve shqiptarë dhe atyre të huaj në marrëdhëniet e punës sanksionon lirinë sindikale, kushte të barabarta punësimi, formim profesional etj. Ligji

³⁴ Vendim Nr. 185, datë 2.4.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së realizimit të kontrollit mjekësor bazë për shtetasit e moshës 35-70 vjeç” (Ndryshuar me VKM nr.721, datë 12.10.2016)(I përditësuar), Pika 2 “2.Të gjithë shtetasit e grupmoshës 35-70 vjeç, me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, përfitojnë pa pagesë nga programi kombëtar i kontrollit mjekësor bazë. Identifikimi i shtetasve të grupmoshës 35- 70 vjeç me qëndrim të përhershëm në Republikën e Shqipërisë realizohet nga të dhënat e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe të regjistrat elektronik, që administrohet nga mjekët e përgjithshëm të qendrave shëndetësore”.

³⁵ Neni 11/2 Ligji Nr. 15/2019. 2. Programet e nxitjes së punësimit përfshijnë angazhimin e punëkërkuesve të papunë në programe të ndryshme punësimi, punësh publike, vetëpunësimi, praktikash profesionale apo trajnimit, për të cilat parashikohet subvencionim, në përqindje të caktuar, i kostove për: a) sigurimet e detyrueshme shëndetësore dhe shoqërore; b) pagat; c) formimin profesional; ç) formimin nëpërmjet punës; d) vetëpunësimin; dh) mbështetjen për bizneset e reja dhe inkubatorët e biznesit; e) pajisjen e vendit të punës dhe përshtatjen e arsyeshme; ë) zbatimin e programeve për mbështetjen e kualifikimit profesional në formën e dyfishtë të arsimit dhe formimit profesional; f) punësimin e të diplomuarve/certifikuarve në arsimin e formimin profesional; g) praktikat profesionale; gj) programin e garancisë rinore; h) programet e riintegritimit social; i) transport për në vendin e punës; j) ndjekjen e kopshteve dhe çerdheve për fëmijët në ngarkim; k) të tjera.

³⁶ Neni 13 Pagesa e të ardhurave nga papunësia. Punëkërkuesit e papunë, të cilët plotësojnë kushtet për përfitimin e të ardhurave nga papunësia dhe regjistrohen në strukturën rajonale/vendore si punëkërkues të papunë në zbatim të legjislacionit për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, përfitojnë nga pagesa e të ardhurave nga papunësia.

përcakton detyrimin që ka punëdhënësi në ofrimin e trajnimeve të vazhdueshme, trajnimet kualifikuese të cilat kërkohen nga pozicioni i punës. Sipas kësaj, punëtorët e huaj dhe ata të BE-së kanë të njëjtat të drejta sindikale si shtetasit vendas. Çdo punonjës ka të drejtë të përcaktojë në mënyrë të pavarur anëtarësimin në sindikatë. Anëtarësimi dhe pjesëmarrja e të punësuarit në organet e punës dhe në sindikata rregullohen me statut ose akte të tjera të sindikatës.

Ligji “Për të huajt” përcakton detyrimin e punëdhënësit për të garantuar përtej kushteve të punësimit dhe ato të strehimit në aplikimin për leje punësimi për punëmarrësin e huaj. Ky ligj shpreh garancitë që ofrohen nga Kushtetuta e RSH (Neni 40) e cila sanksion të drejtën e strehimit në Republikën e Shqipërisë sipas *ligjit për të huajt*. Shërbimet publike ofrojnë garanci të barabartë për shtetas shqiptarë dhe të huaj në të drejtën për të përfutur nga programet e strehimit sidomos kur kemi të bëjmë me viktime të dhunës apo të trafikimit, të mitur të pashoqëruar apo të mitur, apo azilkërkues etj.

C. Të drejtat e qytetarëve të Unionit dhe anëtarëve të familjeve të tyre për të lëvizur dhe banuar lirish në territorin e Shteteve Anëtare (Direktiva 2004/38/KE)

- Çfarë dokumentesh duhet të kenë punëtorët migrantë të BE-së dhe anëtarët e familjeve të tyre (përfshirë ata që nuk janë shtetas të BE-së) për të hyrë në Shqipëri?

Kushtetuta e RSH në neni 39 pika 3, përcakton se *të huajt kanë të drejtën e qëndrimit në territorin e Shqipërisë në respektim të kuadrit ligjor në fuqi*. Sipas këtij neni ndalohet dëbimi kolektiv i të huajve i cili mund të lejohet vetë në kushte të përcaktuara me ligj.

Të gjithë të huajt që hyjnë në Republikën e Shqipërisë duhet të kenë dokumente të vlefshme udhëtimi dhe viza sipas regjimit të vizave të Republikës së Shqipërisë. Marrëveshjet ndërkombëtare apo vendimet e Qeverisë kanë përcaktojë që të huajt nga disa vende mund të hyjnë në Republikën e Shqipërisë pa viza. VKM 858 datë 29.12.2021 përcakton se, shtetasit e BE-së, përjashtohen nga detyrimi i regjistrimit pranë autoritetit përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin ku kanë vendosur vendbanimin. Ato lejohen të hyjnë në territorin e RSH me kartë identiteti të vlefshme.

Ligji Nr. 79/2021 “Për të Huajt”, ka përcaktuar për të huajt që hyjnë në territorin shqiptar, për tu garantuar atyre lëvizjen, qëndrimin dhe punësimin disa tipe lejesh, ku: “leje qëndrimi” autorizon dhe lejon të huajin të qëndrojë në Republikën e Shqipërisë më shumë se 90 ditë brenda 180 ditëve; “leje unike” lejon shtetasin e huaj të qëndrojë ligjërisht në territorin e Republikës së Shqipërisë për qëllime pune; “leje unike për kategori të veçanta” lëshohet nga autoriteti shtetëror përgjegjës për disa kategori të veçanta. Sipas ligjit, shtetasi i huaj ose punëdhënësi i tij / i saj mund të kryejnë një aplikim të vetëm për leje qëndrimi dhe pune në territorin e Republikës së Shqipërisë e cila njihet si “Procedurë e vetme aplikimi”.

Sipas Neni 33, pika 5 përcaktohet se “Shtetasit e Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të vendeve anëtare të Bashkimit Evropian dhe shtetasit e Republikës së Kosovës, kur aplikojnë për herë të parë dhe plotësojnë kriteret e përgjithshme të përcaktuara në nenin 36 të këtij ligji, përfitojnë leje qëndrimi me afat 5-vjeçar”.

Sipas VKM 858/2021³⁷ për të hyrë në Shqipëri shtetasit e huaj duhet të kenë këto dokumente:

Pika B. Dokumentacioni bazë i nevojshëm për të gjitha kategoritë për t’u pajisur me vizë:

³⁷ Disa pika të këtij vendimi janë përmirësuar me Vendimin Nr.243, datë 20.4.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”

1. Formulari i aplikimit për vizë, sipas modelit të përcaktuar në aneksin nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi, i plotësuar dhe i nënshkruar nga aplikuesi, i cili gjendet *on-line* pa pagesë (formulari plotësohet *on-line* dhe shkarkohet nga sistemi).

2. Fotografia e aplikuesit, e cila duhet të jetë bërë jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e aplikimit, me përmasa 47 mm x 36 mm, e marrë në plan me sfond të bardhë, e fokusuar dukshëm dhe qartë. Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me shprehje neutrale dhe sytë të hapur e të dukshëm.

3. Fotokopja e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit, i cili duhet të jetë me vlefshmëri së paku 3 muaj më shumë se afati i vizës së kërkuar dhe të ketë së paku 2 faqe bosh, në të cilat do të vendoset viza pullë, si dhe fotokopja e faqeve me shënime me interes për udhëtimin.

4. Deklarata sipas përcaktimeve ligjore, ku të shprehet pëlqimi i prindit ose i kujdestarit ligjor sipas legjislacionit në fuqi për udhëtimin e të miturit. Në rast të udhëtimit të një të mituri të pashoqëruar apo të shoqëruar nga njëri prind, duhet të paraqitet një deklaram, me anë të cilit prindi/prindërit ose kujdestari ligjor jep/japin pëlqimin e tij/tyre për hyrjen ose daljen e të miturit nga territori i Republikës së Shqipërisë.

5. Ftesa e nënshkruar nga ana e ftuesit.

a) Ftesës i bashkëlidhet një fotokopje e dokumentit të identifikimit të ftuesit. Në rastin kur ftesa është bërë nga një i huaj me qëndrim në Republikën e Shqipërisë, ftesës i bashkëlidhet dhe fotokopja e lejes së tij të vlefshme të qëndrimit.

b) Përjashtohen nga detyrimi i depozitimit të ftesës aplikuesi për vizë të tipit “C” - turizëm, si dhe i huaji investitor/i punësuar/i vetëpunësuar/ punonjës lëvizës digjital në Republikën e Shqipërisë, pensionistë dhe përdorues të pasurisë së paluajtshme në Shqipëri që aplikon për vizë “D”.

Ndërkohë pika C e VKM 858/2021 përcakton dokumentacionin shtesë, në varësi të tipit të vizës së kërkuar³⁸. Në rastin e tipologjisë së vizës “D”³⁹ kërkohet dokumentacioni i përgjithshëm (pika 3 VKM 858/2021):

a) Ftesa nga subjekti pritës, së bashku me fotokopjen e dokumentit të tij të identifikimit me përjashtim të rastit kur i huaji është investitor/i punësuar/i vetëpunësuar/punonjës lëvizës digjital në Republikën e Shqipërisë, pensionistë dhe përdorues të pasurisë së paluajtshme në Shqipëri që aplikon për vizë “D”;

b) Foto pasaporte me përmasat 5cm x 4cm;

c) Dokumenti që provon veprimtarinë apo aftësinë profesionale, tregtare në vendin e aplikuesit, me të cilin lidhen motivet e kërkesës së vizës së aplikuesit;

ç) Në rastin e subjektit tregtar, dokumentet që provojnë statusin juridik të subjektit ftues;

d) Dokumenti që vërteton akomodimin në territorin e Republikës së Shqipërisë;

dh) Dëshmia e miratimit për punësim nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësie për kategoritë që kanë detyrimin për miratimin paraprak për punësim sipas ligjit për të huajt.

VKM e mësipërme pika 3.2 përcakton edhe dokumentacionin e nevojshëm shtesë për vizë për motive të bashkimit familjar (D/BF):

a) Fotokopje e dokumentit të identifikimit të shtetasit shqiptar ose fotokopja e dokumentit të identifikimit të të huajit, si dhe e lejes së tij të qëndrimit, të cilët kërkojnë bashkimin familjar me kërkuesin;

³⁸ Llojet e vizave që ofrohen nga shteti shqiptar janë: Vizë të tipit “A”; vizë të tipit “C” – turizëm; vizë të tipit “C” - turizëm, të organizuar në grupe turistike, nëpërmjet paketave të udhëtimit të një operatori turistik shqiptar ose të huaj; vizë të tipit “C” - për motive shkencore, kulturore, sportive dhe humanitare; vizë të tipit “C” - për motive zyrtare; vizë të tipit “C” - për motive mjekësore; vizë të tipit “C” - për motive profesionale, tregtare dhe biznesi; vizë të tipit “D”.

³⁹ Neni 21 Ligji 79/2021 Vizë e tipit “D” 1. Viza e tipit “D” është viza që lëshohet në formën e një vize pullë ose e printuar në format elektronik për shtetasit e huaj që synojnë të qëndrojnë në Republikën e Shqipërisë më shumë se 90 ditë brenda 180 ditëve, dhe kur, për t’u pajisur me leje qëndrimi, për këta shtetas kërkohet vizë.

b) Certifikatë e lëshuar jo më shumë se një muaj para aplikimit për vizë nga autoritetet përkatëse në vendin e origjinës, e cila vërteton lidhjen e personit, që kërkon bashkim familjar në Shqipëri, ose deklaratë noteriale/marrëveshje noteriale e personave bashkëjetues, ku shprehet bashkëjetesë për më shumë se 12 muaj, shoqëruar me certifikatat personale që vërtetojnë statusin civil pa lidhje martesore të partnerëve;

c) Dokumente të tjera shtesë, si fotografi, filmime etj., që provojnë lidhjen e qëndrueshme me personin, që kërkon bashkim familjar në rast se kërkohet;

ç) Dokumente, që vërtetojnë se pritësi i huaj ka banesë të përshtatshme në Shqipëri dhe plotëson kushtet për banim (fotokopje të noterizuar të kontratës së qirasë apo të një dokumenti që tregon se ka në pronësi një banesë etj.);

d) Fotokopje të noterizuar të dokumentit që vërteton se i huaji pritës është i punësuar apo i vetëpunësuar dhe ka sasi të mjaftueshme të ardhurash për të siguruar jetën e personit/personave që do të vijnë në Republikën e Shqipërisë;

dh) Fotokopje e noterizuar e dokumentit që provon se pritësi i huaj (me banim në Shqipëri) është i punësuar apo i vetëpunësuar dhe ka të ardhura të mjaftueshme për të siguruar jetën e personave që ka ftuar dhe që mund të jenë nën përgjegjësinë e tij;

f) Dokument i lëshuar nga institucionet shqiptare apo shteti ku aplikuesi banon, me të cilin provohet se i huaji ka apo ka pasur së paku njërin prind ose gjysh me shtetësi shqiptare.

b. Dokumentacioni shtesë për motive bashkim familjar me shtetas të huaj:

i. Fotokopja e lejes së qëndrimit të familjarit ftues (në rastin kur ftuesi është shtetas i huaj);

ii. Certifikata familjare dhe/ose e martesës, ku të tregohet sipas rastit lidhja me ftuesin;

iii. Dëshmia e burimeve financiare të mjaftueshme vetëm për ftuesit e huaj për përballimin e jetesës brenda standardeve në Shqipëri, pa iu drejtuar skemës së ndihmës ekonomike;

iv. Deklarata noteriale për bashkëjetesë;

v. Dokumenti ku vërtetohet dhënia e pëlqimit të prindit tjetër kur kërkohet bashkimi familjar vetëm i të miturit/miturve;

vi. Dokument që vërteton se ka sigurim shëndetësor për vete dhe familjen e tij për të cilën kërkon bashkim familjar.

VKM shkon më tej duke përcaktuar dokumentacionin përkatës për të tjera tipologji kërkesash apo aplikimesh për vizë të tipit “D” si psh:

3.10 Dokumentacioni shtesë për vizë tipi “D” si punëmarrës (D/PM)/për të transferuarit brenda ndërmarrjes (D/T):

a) Deklarata e transferimit brenda ndërmarrjes.

3.11 Dokumentacioni shtesë për vizë tipi “D” si punëtor stinor (D/PS):

a) Dokumenti, i cili provon regjistrimin e të huajit, që kërkon vizë në institucionet përgjegjëse të punësimit në vendin e origjinës, të njohura sipas marrëveshjeve për punësim sezonal;

b) Një kontratë e vlefshme pune për aktivitet pune stinor, me afat të përcaktuar deri në 6 muaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi që rregullon marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë;

c) Dokumentacioni që provon akomodimin e punëtorit sezonal.

3.15 Dokumentacioni shtesë për vizë tipi “D” për punonjës me kualifikim të lartë (D/KL):

a) Diploma e kualifikimit të arsimit të lartë;

b) Një kontratë e vlefshme pune në përputhje me legjislacionin në fuqi, që rregullon marrëdhëniet e punës në Republikën e Shqipërisë.

3.16 Dokumentacioni shtesë për vizë tipi “D” për persona të vetëpunësuar (D/NP):

a) Vërtetimi i aftësisë profesionale me të cilin lidhet miratimi i vetëpunësimit (diplomë, certifikatë, trajnime, kualifikime të ndryshme);

b) Dokumenti i statusit juridik të subjektit.

3.17 Dokumentacioni shtesë për vizë tipi "D" për punonjës lëvizës digjital (D/LD):

a) Kontratë e vlefshme punësimi me punëdhënësin jashtë shtetit apo kontratë shërbimi me kontraktuesin ose porositësin jashtë shtetit se do të punojë pa një seli konkrete për punë specifike, të cilat lejojnë punën me mjete të teknologjisë së informacionit.

3.18 Dokumentacioni shtesë për vizë tipi "D" për investitorë (D/I):

a) Dokumenti që vërteton investime të kryera në vendin e origjinës ose rezidencës ose projekte në zhvillim në Republikën e Shqipërisë.

3.19 Dokumentacioni shtesë për vizë tipi "D" për shërbime kontraktuese (D/SHK):

a) Kontratë shërbimi me subjektin e regjistruar në Republikën e Shqipërisë;

b) Vërtetim për kualifikimet përkatëse profesionale që lidhen me ofrimin e shërbimit sipas legjisllacionit në fuqi.

3.21 Dokumentacion për vizë tipi "D" për përdorim të pasurisë së paluajtshme në pronësi (D/PPP):

a) Certifikata e pronësisë;

b) Dëshmia e burimeve financiare të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet, për periudhën e kërkuar të qëndrimit;

c) Deklarata individuale mbi motivin e qëndrimit në Shqipëri.

3.22 Dokumentacioni për vizë tipi "D" për pensionistët (D/P):

a) Dokument pensioni nga vendi i origjinës ose i rezidencës;

b) Vërtetim i të ardhurave vjetore, minimumi në vlerën 1 200 000 (një milion e dyqind mijë) lekë nga pensioni në shtetin e origjinës.

Në rastin e aplikimit për leje qëndrimi, VKM 858 /2021 ka përcaktuar si dokument të përgjithshëm dhe të nevojshëm:

I huaji depoziton edhe *on-line* këto dokumente:

1. Formularin e aplikimit për lëshimin e lejes së qëndrimit përkatësisht të plotësuar dhe të nënshkruar nga aplikuesi, sipas modeleve të përcaktuara në anekset nr. 8 dhe nr. 9, që i bashkëlidhen këtij vendimi, i cili gjendet *on-line* pa pagesë, fotografi të aplikuesit, të bëra jo më përpara se 6 (gjashtë) muaj nga data e aplikimit, me përmasa 47 mm x 36 mm, të marra në plan me sfond të bardhë, të fokusuar dukshëm dhe qartë. Fotografia duhet të tregojë personin përballë, me qëndrim neutral e sytë të hapur e të dukshëm.

2. Fotokopjen e dokumentit të vlefshëm të udhëtimit me të cilin i huaji ka hyrë në Republikën e Shqipërisë, si dhe fotokopjen e faqeve me shënime me interes për udhëtimin, si dhe gjenealitetet e mbajtësit, viza e tipit "D", vulat në hyrje-dalje.

3. Dokumentet që provojnë akomodim të përshtatshëm në Shqipëri.

4. Kontratën e blerjes ose të marrjes me qira të banesës, në përputhje me standardet e banimit në Shqipëri ose çdo dokument tjetër që provon strehimin e garantuar në Republikën e Shqipërisë.

Dokumentacioni shtesë sipas llojit të lejes së qëndrimit të përkohshme:

1. Dokumentacioni shtesë për motive të bashkimit familjar:

a. Dokumentacioni shtesë për motive bashkim familjar me shtetas shqiptar:

i. Fotokopja e dokumentit të identifikimit të shtetasit shqiptar;

ii. Certifikata familjare dhe/ose e martesës, ku të tregohet sipas rastit lidhja me ftuesin;

iii. Dëshmia e burimeve financiare të mjaftueshme vetëm për ftuesit e huaj për përballimin e jetesës brenda standardeve në Shqipëri, pa iu drejtuar skemës së ndihmës ekonomike (vetëm për bashkim familjar për partnerë civilë);

iv. Deklarata noteriale për bashkëjetesë për bashkim familjar për partnerë civilë;

v. Dokumenti ku vërtetohet dhënia e pëlqimit të prindit tjetër kur kërkohet bashkimi familjar vetëm i të miturit/miturve;

vi. Dokumenti që vërteton se ka sigurim shëndetësor për vete dhe familjen e tij për të cilën kërkon bashkim familjar.

b. Dokumentacioni shtesë për motive bashkim familjar me shtetas të huaj:

i. Fotokopja e lejes së qëndrimit të familjarit ftues (në rastin kur ftuesi është shtetas i huaj);

ii. Certifikata familjare dhe/ose e martesës, ku të tregohet sipas rastit lidhja me ftuesin;

iii. Dëshmia e burimeve financiare të mjaftueshme vetëm për ftuesit e huaj për përballimin e jetesës brenda standardeve në Shqipëri, pa iu drejtuar skemës së ndihmës ekonomike;

iv. Deklarata noteriale për bashkëjetesë;

v. Dokumenti ku vërtetohet dhënia e pëlqimit të prindit tjetër kur kërkohet bashkimi familjar vetëm i të miturit/miturve;

vi. Dokument që vërteton se ka sigurim shëndetësor për vete dhe familjen e tij për të cilën kërkon bashkim familjar.

f. Dokumentacioni shtesë për viktimat e trafikimit të qenieve njerëzore:

i. Fotokopja e dokumentit të udhëtimit (nëse i huaji e ka);

ii. Kërkesa nga autoritetet përgjegjëse që trajtojnë të huajin për pajisje me leje qëndrimi, ku përcaktohet statusi ose parashtrohet arsyeja për çdo rast.

g. Dokumentacioni shtesë për personat pa shtetësi:

i. Fotokopja e dokumentit të udhëtimit (nëse i huaji e ka);

ii. Dëshmia nga autoritetet kompetente mbi statusin e personit pa shtetësi.

Ç. Në rastin e procedurës së përgjithshme për t'u pajisur me leje unike, kjo realizohet npr aplikimit on-line, nga vetë i huaji, nga punëdhënësi i tij, personi i autorizuar nga i huaji. Dokumentacioni shtesë për t'u pajisur me leje unike:

a. Dokumentacioni shtesë për leje unike si punëmarrës:

i. Kontrata e punës si punëmarrës me një punëdhënë, në përputhje me formimin e tij profesional (kontrata e punës duhet të përmbajë të gjitha kërkesat e përcaktuara në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë për këtë dokument), ose kategorizimi si punëkërkues, në përputhje me marrëveshje reciproke ndërqeveritare.

ii. Dëshmi aftësimi (diploma/certifikata/referenca) ose vetëdeklarim për eksperiencën në punë që vërteton aftësitë profesionale në përputhje me punën që do të kryejë sipas kontratës së punës.

b. Dokumentacioni shtesë për leje unike si punëtor stinor:

i. Kontrata e punës si punëmarrës stinor me një punëdhënë, me një afat të përcaktuar deri në 6 muaj, në përputhje me formimin e tij profesional; (kontrata e punës duhet të përmbajë të gjitha kërkesat e përcaktuara në Kodin e Punës të Republikës së Shqipërisë për këtë dokument);

ii. Në rast se kontrata/oferta e punës e të huajit përcakton se aktiviteti që do të ushtrojë është një profesion i rregulluar, i huaji duhet të plotësojë kushtet e përcaktuara në përputhje me të drejtën kombëtare të ushtrimit të profesioneve të rregulluara. Emërtimi i profesionit në dokument duhet të jetë në përputhje me Listën Kombëtare të Profesioneve ose me të njëjtat aftësi të përcaktuara nga ESCO-ja.

c. Dokumentacioni shtesë për leje unike si i transferuar brenda ndërmarrjes (TBN):

i. Deklaratë e transferimit brenda ndërmarrjes;

ii. Dokument (kontratë pune) ndërmjet punonjësit dhe ndërmarrjes dërguese, në të cilën specifikohen pozicioni i punës, aktivitetet që do të kryhen dhe elementet e tjera të kontratës së punës, sipas legjislacionit shqiptar.

ç. Dokumentacioni shtesë për leje unike si punëtor ndërkufitar:

iii. Kontrata e punës e lidhur me punëdhënësin nëse është me statusin e punëmarrësit ose dokumentacion për statusin e tij si punëdhënësi/i vetëpunësuar;

iv. Dokumentacioni që vërteton se punëdhënësi e ka punësuar në kuadër të një marrëveshjeje (nëse ka);

v. Dokumentacioni që i huaji provon se ka vendbanim në një zonë gjeografike kufitare të territorit të Republikës së Shqipërisë.

ë. Dokumentacioni shtesë për leje unike për punonjës me kualifikim të lartë:

xi. Dokumentacioni i përcaktuar për qëndrimin e përkohshëm;

xii. Kontrata e vlefshme pune me një punëdhënësi, për punësim me kualifikim të lartë, në përputhje me formimin e tij profesional, me kohëzgjatje së paku 1-vjeçare në Republikën e Shqipërisë, ku disponon dëshminë e kualifikimit të lartë profesional mbi nivelin e 4 (katërt) të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve;

xiii. Dokumenti që vërteton kualifikimet e larta profesionale përkatëse në profesionin/pozicionin e punës apo sektorin e specifikuar në kontratën e punës për profesionet e parregulluara.

f. Dokumentacioni i veçantë për leje unike për shërbime kontraktuese:

i. Dokumentacioni i përcaktuar për qëndrimin e përkohshëm;

ii. Miratimi për punësim për shërbime kontraktuese.

g. Dokumentacioni shtesë për leje unike për të vetëpunësuar:

i. Dokumentacioni përkatës për qëndrimin si i vetëpunësuar;

ii. Vlerësimi nga komisioni përkatës për të vetëpunësuarit.

gj) Dokumentacioni shtesë për leje unike për punonjës lëvizës digjital:

i. Dokumentacioni i përcaktuar për qëndrimin e përkohshëm;

ii. Kontratë e vlefshme punësimi me punëdhënësin jashtë shtetit apo kontratë shërbimi me kontraktuesin ose porositësin jashtë shtetit, që provon se do të punojë pa një seli konkrete për punë specifike, të cilat lejojnë punën me mjete të teknologjisë së informacionit;

iii. Dëshmi e burimeve financiare të mjaftueshme për të mbajtur veten dhe personat në ngarkim gjatë qëndrimit në Republikën e Shqipërisë.

h) Dokumentacioni shtesë për leje unike për investitorë:

i. Dokumentacioni i përcaktuar për qëndrimin e përkohshëm si investitor;

ii. Vlerësimi nga komisioni përkatës për investitorët.

i. Dokumentacioni shtesë për leje unike për kategori të veçanta:

i. Dokumentacioni përkatës për lejen e qëndrimit;

ii. Kontrata e vlefshme e punës/kontratë shërbimi/marrëveshje.

Kuadri ligjor si më lart prodhon të drejta dhe ofron garanci jo vetëm për të huajt me qëndrim të rregullt në Shqipëri por edhe për familjarët e tyre, duke ofruar kushte lehtësimi të mirëpërcaktuara për hyrjen, qëndrimin, punësimin, jetesën dhe daljen nga territori i RSH. Neni 41 i Ligjit 79/2021 përcakton kushtet dhe kriteret që duhet të plotësohen nga i huaji për t'u bashkuar me familjarët e tyre në truallin shqiptar gjatë kohës së qëndrimit të tyre. Neni 42 i këtij ligji përcakton kushtet e përfitimit të një leje qëndrimi autonome prej bashkëshortit/tes apo bashkëjetuesit/es, si dhe fëmijëve në moshë madhore, të pajisur me leje qëndrimi për bashkim familjar, pasi kanë qëndruar në mënyrë të vazhdueshme së paku 5 vjet në territorin e Republikës së Shqipërisë me leje qëndrimi për bashkim familjar dhe me kusht që të mos kenë marrë leje qëndrimi për arsye të ndryshme nga ajo e bashkimit familjar (etj....). Neni 43 garanton të drejtën për bashkim familjar të refugjatëve, me anëtarët e familjes së tij konform dispozitave të legjislacionit në fuqi për azilin.

D. Ruajtja e të drejtave të pensioneve suplementare të personave të punësuar dhe të vetëpunësuar brenda BE-së (Direktiva 98/49/EC)

- A ekzistojnë skema pensionesh suplementare (ose private) në Shqipëri?

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, Neni 52 ka sanksionuar se: “1. Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj. 2. Kushdo, kur mbetet pa punë për shkaqe të pavarura nga vullneti i tij dhe kur nuk ka mjete të tjera jetese, ka të drejtën e ndihmës në kushtet e parashikuara me ligj”.

Përshtatshmëria e skemave të sigurimeve shoqërore dhe njohja e pensioneve profesionale rregullohen nëpërmjet marrëveshjeve dypalëshe. Politikat e pranimit të emigrantëve nuk vendosin pengesa ndaj vendbanimit të përhershëm të familjarëve të punëtorëve nga vendet e BE-së.

Ligji nr.7703 datë 11.05.1993 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë” (i ndryshuar), krijoi një sistem të detyrueshëm, publik dhe me mbulim universal të sigurimeve shoqërore dhe një kolonë suplementare vullnetare, e cila momentalisht nuk paraqitet e zhvilluar me gjithë masat që janë marrë dhe kuadrin ligjor tashmë të plotësuar.

Sistemi i detyrueshëm përbëhet nga: i. Një skemë sigurimesh shoqërore e detyrueshme⁴⁰; ii. Një skemë vullnetare⁴¹; iii. Një skemë suplementare⁴²; iv. Pensione të veçanta⁴³.

Cilat janë garancitë që ofron sistemi i Sigurimeve shoqërore për të huajt në Shqipëri⁴⁴?

Ligji Nr.7703, datë 11.05.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka të shprehur në përmbajtjen e tij normat e vendosura nga aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga RSH, si parimin e trajtimit të barabartë për çdo individ që i nënshtrohet këtij legjislacioni përfshirë edhe shtetasit e huaj.

Neni 7, i këtij ligji lidhur mbrojtjen për shtetasit shqiptarë jashtë shtetit dhe shtetasit e huaj përcakton se: “Sigurimet shoqërore iu japin mbrojtje edhe: a) shtetasve shqiptarë dhe personave pa shtetësi, ish-shtetas shqiptarë, që janë jashtë shtetit, në përputhje me konventat, marrëveshjet dypalëshe dhe Rregulloren e Institutit të Sigurimeve Shoqërore; b) shtetasve të huaj dhe personave pashtetësi, që punojnë në Shqipëri”.

Mbulohen me sigurim shoqëror të detyrueshëm të gjitha kategoritë e përcaktuara në ligj dhe përfitojnë nga skema, të gjithë personat pa dallim gjinie. Kriteret e përfitimit janë unike për të gjithë pjesëmarrësit në skemën e sigurimeve.

Skema e sigurimeve të detyrueshme shoqërore në Shqipëri është një skemë e bazuar në parimin kontributiv ku përfitimet janë të lidhura drejtpërdrejt me kontributet. Të gjithë personat e punësuar ose të vetëpunësuar janë të detyruar të paguajnë kontribute.

Për personat e punësuar (përfshirë edhe shtetas të huaj) legjislacioni i sigurimeve shoqërore detyron punëdhënësin të mbajë kontributet e sigurimeve shoqërore dhe të bëjë derdhjen e tyre

⁴⁰ Kjo skemë administrohet nga Insituti i Sigurimeve Shoqërore dhe mbulon të punësuarit në shtet dhe në sektorin privat dhe të vetëpunësuarit në zonat urbane dhe rurale, me kusht që ata të kenë kontribuar për një kohë të përcaktuar në skemë.

⁴¹ Kjo skemë përfshin ata përfituar që nukë janë më përfitues por duan të vazhdojnë të jenë si edhe ata që nuk janë të mbuluar nga ligji përfshi edhe studentët e universitetit.

⁴² Nga kjo skemë përfitojnë funksionet e larta kushtetuese, shërbimi civil dhe ushtarakët e punësuar në ushtri, në polici dhe në shërbimin informativ. Pensionet suplementare financohen drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit.

⁴³ Përfitues janë ata që kanë marrë pjesë në luftë, që kanë tituj në fushën e kulturës, arteve, ekonomisë dhe politikës si edhe të përndjekurit nga regjimi totalitar. Pensionet e veçanta financohen gjithashtu drejtpërdrejt nga buxheti i shtetit. Ligji i sigurimeve shoqërore u jep mbrojtje të punësuarve edhe në rastin e sëmundjeve, papunësisë, aksidenteve në punë dhe në rastin e barrë lindjes.

⁴⁴ <https://www.iss.gov.al>

në llogari të administratës tatimore. Në rast të mospagesës së kontributeve legjislativi i sigurimeve shoqërore parashikon sanksione.

Bazuar në nenin 13 i Ligjit Nr. 7703/1993 përcakton se: “1. Kontributet do të paguhen nga personat e siguruar; 2. Kontributet e personave të punësuar nën një kontratë pune do të ndahen ndërmjet personit të siguruar dhe punëdhënësit të tij, në përputhje me dispozitat e këtij Ligji dhe do të derdhen nga punëdhënësi; 3. Personat e detyruar për derdhjen e kontributeve janë përgjegjës për llogaritjen dhe pagesën e tyre. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë nga paga e të punësuarve kontributet dhe t’i derdhë ato në llogari të administratës tatimore, sipas kriterëve dhe procedurave të përcaktuara me Ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore e shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.”

Bazuar në nenin 3 të ligjit 7703 “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”i ndryshuar, si dhe Rregulloren Nr. 4, datë 25.05.2009, “Për sigurimin vullnetar në Institutin e Sigurimeve Shoqërore” parashikohet mbulimi me sigurimi shoqëror vullnetar. Kanë të drejtë për sigurim vullnetar shtetasit shqiptarë që kanë mbushur moshën 18 vjeç deri në arritjen e moshës për pension sipas nenit 92 të ligjit Nr. 7703/1993, ndërsa personat që ka lënë shtetësinë shqiptare, mund të bëjë sigurim vullnetar vetëm për periudhën nga 1.1.1994 deri më datën kur ka lënë shtetësinë.

Shtetasve të huaj që kanë punuar në Shqipëri dhe që janë subjekt i marrëveshjeve dypalëshe në fuqi në fushën e sigurimeve shoqërore ju garantohej e drejta për përfitime nga legjislativi shqiptar nëse nga bashkimi i periudhave të sigurimit të realizuara në të dy shtetet plotësohen kushtet.

Sipas llojit të përfitimit të caktuar kryhet eksportimi i përfitimeve nga Shqipëria në shtetin e huaj dhe anasjelltas pa kufij dhe pa zbritje. Transferimi i përfitimeve të dhëna në përputhje me legjislativin shqiptar (përfitime për pension pleqërie, familjar apo invaliditeti), nënkupton, që pagesa i dërgohet përfituesit atje ku ai banon, në atë vend, në territorin e shtetit tjetër kontraktues ose edhe në një shtet të tretë ku ai ka vendbanimin e përhershëm, qoftë ky shtetas shqiptar apo i huaj.

Bashkërendimi i sistemit të sigurimeve shoqërore

Koordinimi i skemave të sigurimeve shoqërore ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera është në pajtim me Nenin 48 e 99 të Marrëveshjes së Stabilizim Asociimit. Nenet 46, 47, 49, 50, 51, 53, 54, 55, 56, 57, 58, 59, 70 SAA përcaktojnë shtyllat e bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Bashkimit Evropian në fushën e aksesit në tregun e punës për qytetarët e BE-së.

Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka ndërmarrë angazhimin për të koordinuar skemat e sigurimeve shoqërore, për të siguruar lirinë e lëvizjes së shtetasve shqiptarë dhe gjithashtu të drejtën e punëtorëve për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat si përfitues të sigurimeve shoqërore. Procesi i koordinimit të skemave të sigurimeve shoqërore me vendet e tjera është një nga angazhimet thelbësore për t’u bërë pjesë e familjes evropiane. Trajtimi i punëtorëve që janë shtetas shqiptarë dhe të cilët janë të punësuar ligjërisht në territorin e një Shteti Anëtar rregullohet sipas Neneve 46 dhe 47 të MSA.

Procesi i koordinimit të skemave të sigurimeve shoqërore me vendet e tjera është një nga angazhimet thelbësore për t’u bërë pjesë e familjes evropiane.

Shteti Shqiptar ka lidhur dhe ratifikuar marrëveshje dypalëshe mbi sigurimet shoqërore me Belgjikën, Republikën Çeke, Gjermaninë, Luksemburgun, Hungarinë, Austrinë, Maqedoninë

Phone

+355 69 402 0057

Address

Rr.“Frederik Shiroka” Pallati “Alba”, Shk. 4, Ap. 7

Website

www.clr.al

e Veriut, Bullgari dhe Turqinë. Negociatat me Zvicrën dhe Kanadanë kanë përfunduar. Marrëveshja me Kosovën u ratifikua në prill 2019. Ka pasur shkëmbime për koordinimin e skemave të sigurimeve shoqërore me Spanjën, Francën dhe Kroacinë. Është hartuar një marrëveshje bashkëpunimi teknik për të vazhduar negociatat për një marrëveshje dypalëshe për koordinimin e skemave të sigurimeve shoqërore me Italinë.

Priten të hyjnë në fuqi marrëveshjet dypalëshe me:

- Rumaninë, e ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr. 42 datë 14.04.2016;
- Kanadanë e ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar me Ligjin Nr. 58, datë 12.09.2019.

Marrëveshja me Konfederatën Zvicerane, e miratuar me VKM Nr. 533, datë 31.07.2019 “*Për Miratimin në Parim të Marrëveshjes, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Konfederatës Zvicerane, për Mbrojtjen Shoqërore*”, është firmosur në shkurt 2022.

Marrëveshja me Republikën e Bullgarisë është miratuar në parim me VKM Nr. 820, datë 24.12.2021. Marrëveshja me Republikën e Kosovës u miratua në parim me VKM Nr. 719, datë 24.11.2021. Është në proces ratifikimi në Parlament. Me Malin e Zi, Shqipëria është në rrugë për hapjen e bisedimeve për dakordësimin e një marrëveshjeje dypalëshe.

Procesi për realizimin e marrëveshjeve për mbrojtjen sociale bazohet kryesisht në normat e Rregullores nr. 883/2004 të Këshillit të Evropës, “*Për koordinimin e sistemeve të mbrojtjes sociale*”, por edhe në veçoritë dhe karakteristikat e legjislacionit të vendeve të përfshira në proces negociimi.

- A ka një bazë të dhënash kombëtare për vendet e lira? A ka një faqe interneti kombëtare për ta vende te lira pune? Si shfaqen vendet e lira të punës në këtë faqe interneti?

Lidhur me përgatitjen për t’iu bashkuar EURES (Rrjeti Evropian i Shërbimeve të Punësimit), Shqipëria ka krijuar një databazë të integruar për sistemin e shërbimit të punësimit. Kjo synon lehtësimin e shkëmbimit të informacionit ndërmjet departamenteve TI të gjendjeve civile, të sistemit tatimor, sistemit të kujdesit të detyrueshëm shëndetësor dhe sistemit të ndihmës ekonomike.

Fakt është që nga të dhënat e INSTAT rezulton se qytetarët italianë, të cilët përbëjnë numrin më të madh të qytetarëve të BE-së në tregun shqiptar të punës, janë të punësuar kryesisht në fushën e mjekësisë, shërbimeve, marketingut, tregtisë, industrisë përpunuese, informacionit dhe telekomunikacionit. Qytetarët rumunë, të cilët janë grupi i dytë më i madh i qytetarëve të BE-së që hyjnë në Republikën e Shqipërisë, janë të punësuar kryesisht në fushën e tregtisë dhe shërbimeve dhe call centers, etj.

Kapitulli II

Konkluzione

Raporti evidentoi të gjithë kuadrin ligjor dhe institucional që synon përafrimin me *Acquis* të Bashkimit Europian. Edhe pse janë bërë hapa përpara në përmirësimin e kuadrit ligjor, ende ky harmonizim nuk është i plotë.

Miratimi i ligjit 79/2021 “*Për të huajt*”, sjell domosdoshmërisht nevojën për përshtatje të akteve nënligjore me ligjin e ri, si dhe të trajnimeve të punonjësve të AKPA dhe hartimit të manualeve për zbatimin e duhur të legjislacionit në fuqi.

Mangësitë ligjore dhe institucionale për aktet ligjore të kapitullit Nr.2 në legjislacionin vendas, trajnime të punonjësve të institucioneve të përfshira në përafrimin e legjislacionit të këtij kapitulli duhet të jenë në fokus të një analize të përditësuar.

Aksesi në tregun e punës duhet të vlerësohet si një mundësi e barabartë për të gjithë përfituesit, shtetas shqiptarë a të huaj dhe një analizë e detajuar e sektorëve do të evidentojë mundësitë reale të aksesit të shtetasve të BE në to dhe barrierat që ekzistojnë. Për të bërë të mundur këtë, kërkohen kapacitete njerëzore dhe infrastrukturë për ta realizuar.

Përpjekjet e shtetit shqiptar janë të orientura drejt një zhvillimi të sistemit IT si kërkesë për tu lidhur me EURES, gjë që do t’u ofrojë qytetarëve të BE-së akses në punësim në Shqipëri, trajtim të barabartë me shtetasit shqiptarë në aspektin e punësimit, kushtet e punësimit, shpërblimit, studimit dhe formimit profesional.

Puna e vazhdueshme në përafrimin me *acquis* në fushën e lëvizjes së lirë të punonjësve kërkon zbatim efektiv të legjislacionit në fuqi në fushën e të huajve, punësimit, formimit e arsimit profesional si dhe i kushteve të punës dhe marrëdhënieve të punës, për shtetasit e BE-së në Republikën e Shqipërisë.

Një nga sfidat më të mëdha të aderimit në BE lidhet me mundësinë e koordinimit të skemave të sigurimeve shoqërore për qytetarët shqiptarë që jetojnë dhe punojnë jashtë vendit, si dhe punëtorët e Shteteve Anëtare të BE-së të punësuar në Shqipëri. Kjo kërkon nënshkrimin e marrëveshjeve të mbrojtjes sociale me shumë vende të tjera të BE-së.

Bibliografia

Ligje:

- European Commission Brussels, 9.11.2016 com(2016) 715 Final communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2016 communication on EU enlargement policy -Migrant integration policy index 2020 -Albania
- European Commission Brussels, 6.10.2020 swd(2020) 354 Final Commission staff working document Albania 2020, Report accompanying the communication from the Commission to the European Parliament, the Council, the European Economic and Social Committee and the Committee of the Regions 2020, communication on EU enlargement policy
- Annual report on the implementation of IPA ii assistance, Under direct and indirect management, period covered by the report: 01/01/2020-31/12/2020, Tirana 2020
- Dokumenti i politikave të pensioneve, Ministria e Mirwqenies Sociale dhe Rinisw
- Commission, “commission staff working paper on albania stabilisation and association report (communication) com (2011) 666 final
- Commission, “commission staff working paper on albania stabilisation and association report (communication) com (2012) 600 final
- Commission, “commission staff working paper on albania stabilisation and association report (communication) com (2013) 700 final
- Council directive 2004/58/ec of 29 april 2004 is about the right of citizens of the union and their family members to move and reside freely within the territory of the eu and eea member states [2004] oj l 229/35 article 3
- Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*, Tiranë, Qendra e Botimeve Zyrtare, 2016, ISBN 978-9928-01-057-5
- Ligj nr. 18/2017 “Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës”
- Ligj nr. 79/2021 “Për të huajt”
- Ligj Nr. 10 383, Datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë” (i përditësuar), ndryshuar me: Ligjin nr. 126/2013, datë 25.4.2013 është botuar në fletoren zyrtare nr. 76, datë 10 maj 2013, Ligji nr. 184/2013, datë 28.12.2013 është botuar në fletoren zyrtare nr. 203, datë 30 dhjetor 2013, Ligji nr. 141/2014, datë 23.10.2014 është botuar në fletoren zyrtare nr. 175, datë 18 nëntor 2014, Ligji nr. 145/2015, datë 17.12.2015 është botuar në fletoren zyrtare nr. 244, datë 11 janar 2016, Akti normativ Nr. 1, datë 25.1.2017 është botuar në fletoren zyrtare nr. 11, datë 27 janar 2017.
- Ligj Nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil” (ndryshuar me ligjin nr. 178/2014 dhe ligjin 41/2017)
- Ligj nr. 121/2014 “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”
- Ligj nr. 13/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 108/2013, “Për të huajt”, të ndryshuar
- Ligj nr. 108/2013 “Për të huajt”
- Ligj nr. 15/2019 “Për nxitjen e punësimit”
- Vendim nr. 81, datë 12.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, ripërtëritjen, refuzimin dhe anulimin e lejes së punës, si punëmarrës, të tipit “A/P”

Phone

+355 69 402 0057

Address

Rr.“Frederik Shiroka” Pallati “Alba”, Shk. 4, Ap. 7

Website

www.clr.al

- Vendim nr. 75, datë 12.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejes së punës, si punëtor stinor, të tipit "A/PS"
- Vendim nr. 85, datë 12.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit e të procedurës, për pajisjen, refuzimin dhe anulimin e lejes së punës, për të transferuarit brenda ndërmarrjes, të tipit "A/TN"
- Vendim nr. 76, datë 12.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës për studentë, të tipit "A/S"
- Vendim nr. 77, datë 12.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës për punësim ndërkufitar, të tipit "A/NK"
- Vendim nr. 82, datë 12.2.2014 “Për përcaktimin e kriterëve, të dokumentacionit e të procedurës për pajisjen, refuzimin, ripërtëritjen dhe anulimin e lejes së punës, për formim profesional, të tipit "A/FP"
- Udhëzim nr. 293, datë 4.6.2015 “Mbi procedurat e trajtimit të shtetasve të huaj me qëndrim të parregullt në territorin e Republikës së Shqipërisë”
- Vendim nr. 858, datë 29.12.2021 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”,
- Vendim nr.91, datë 9.2.2022 “Për miratimin e Planit Kombëtar për integrimin Evropian 2022–2024”
- Vendim nr.151, datë 19.2.2020 “Për miratimin e planit kombëtar për integrimin evropian 2020–2022”
- Vendim nr. 858, datë 29.12.2021 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”
- Vendim nr.243, datë 20.4.2022 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.858, datë 29.12.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”
- Vendim nr. 185, datë 2.4.2014 “Për përcaktimin e mënyrës së realizimit të kontrollit mjekësor bazë për shtetasit e moshës 35-70 vjeç”(ndryshuar me vkm nr.721, datë 12.10.2016)(i përditësuar)
- Vendim nr. 307, datë 21.5.2014 “Për regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor” (i ndryshuar me vendimin nr. 74, datë 7.2.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për një ndryshim në vendimin nr. 307, datë 21.5.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për regjistrimin dhe identifikimin e personave të siguruar nga sigurimi i detyrueshëm shëndetësor”) i përditësuar

Strategji:

- Këshilli i Ministrave, *Strategjia kombëtare për zhvillim dhe integrim 2015-2020*, Maj 2016
- *Plani kombëtar për integrimin evropian 2016 – 2020*, Janar 2016
- *Strategjia kombëtare për punësim dhe aftësi 2019 – 2022*, “Aftësi më të larta dhe punë më të mirë për të gjithë, femrat dhe meshkujt.” 2019
- Ministry of Social Welfare and Youth, *Employment and skills strategy 2014-2020*, “Higher skills and better jobs for all women and men”, February 2014
- Strategjia ndërsektoriale e menaxhimit të integruar të kufirit (2021 – 2027)*

Publikime

- Avokati i Popullit, *Fëmijët migrantë dhe të drejtat e tyre. Roli i institucionit të Avokatit të Popullit, Seksioni për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve.*
- Arqimandriti, M, Llubani, M, Çoku, O., & Hoxha, E., *Diskriminimi me bazë gjinore dhe puna në Shqipëri, Qendra Aleanca Gjinore për Zhvillim, Shqipëri, 2019*
 - Danaj, S. & Zólyomi, E. (2019). *Institutional Capacities for Implementing the Posting of Workers Directive in the Western Balkans: A Needs Assessment.* Vienna: European Centre for Social Welfare Policy and Research.
 - Lika, M. *Europeanisation of Albanian Legal System in the area of free movement of workers,* Beder University, Albania
 - Hoxhaj, A., *The EU rule of law initiative towards the Western Balkans,* Hague Journal on the Rule of Law (2021) 13:143–172, <https://doi.org/10.1007/s40803-020-00148-w> , 2020
 - Taska, E & Zela, N., *Marrëdhëniet e punës në një këndvështrim të ri, Disa aspekte të rëndësishme në lidhje me punësimin,* Departamenti i Administratës Publike, Dhjetor, 2010
 - Zajmi I, “*The legal obligations of albania in the stabilization and association agreement between Albania and EU*” [2013] Volume 10 Journal of US-China public administration 663
 - www.instat.gov.al
 - <https://www.issk.gov.al>

Phone

+355 69 402 0057

Address

Rr."Frederik Shiroka" Pallati "Alba", Shk. 4, Ap. 7

Website

www.clr.al

CLR.AL

Centre for Labour Rights
Qendra për të Drejtat në Punë

Phone

+355 69 402 0057

Address

Rr."Frederik Shiroka" Pallati "Alba", Shk. 4, Ap. 7

Website

www.clr.al